



Città di Bolzano
Stadt Bozen

Emigracioni në Bolzano

UDHËZUES
PËR SHËRBIME

SHQIP

AUTONOME
PROVINZ
BOZEN
SÜDTIROL



PROVINCIA
AUTONOMA
DI BOLZANO
ALTO ADIGE



CUON
savera

COOPERATIVA SOCIALE | SOZIALGENOSSENSCHAFT

Osservatorio per le politiche sociali e la qualità della vita

Immigrazione a Bolzano – Guida ai servizi

Stesura: Cooperativa Savera

Editore: Comune di Bolzano – Osservatorio per le Politiche sociali e la Qualità della vita
Vicolo Gumer 7, 39100 Bolzano

Contatto: osservatorio@comune.bolzano.it

Coordinamento Comitato Scientifico e supervisione alla pubblicazione:

Carlo Alberto Librera

Layout: mediamacs.design

Aggiornamento testi e traduzione: Erjon Zeqo

È consentita la riproduzione d'informazioni, grafici e tabelle previa indicazione della fonte. Citazione: Comune di Bolzano. Immigrazione a Bolzano – GUIDA AI SERVIZI. Osservatorio per le Politiche sociali e la Qualità della vita, Ripartizione Servizi alla Comunità Locale, Comune di Bolzano. Questa pubblicazione è scaricabile dal sito del Comune di Bolzano www.comune.bolzano.it sotto la sezione "Osservatorio per le Politiche sociali e la Qualità della vita" e sotto la sezione Home > Servizi > I servizi per > I servizi per... > Cittadini con background migratorio e i cittadini comunitari > Pubblicazioni

Beobachtungsstelle für Sozialpolitik und Lebensqualität

Einwanderung in Bozen – Ein Ratgeber zu den Dienstleistungen

Verfasserin: Genossenschaft Savera

Herausgeber: Stadtgemeinde Bozen – Beobachtungsstelle für Sozialpolitik und Lebensqualität – Gumergasse 7, 39100 Bozen

Kontakt: beobachtungsstelle@gemeinde.bozen.it

Wissenschaftliche Leitung und Forschungscoordination: Carlo Alberto Librera

Layout: mediamacs.design

Textergänzung und Übersetzung: Erjon Zeqo

Die Verwendung der bereitgestellten Inhalte, Grafiken und Tabellen ist unter Angabe der Quelle gestattet. Quellenangabe bei Zitaten: Gemeinde Bozen, Einwanderung in Bozen – Ein Ratgeber zu den Dienstleistungen. Beobachtungsstelle für Sozialpolitik und Lebensqualität, Abteilung für Dienste an die örtliche Gemeinschaft, Stadtgemeinde Bozen. Dieser Text kann im Internet unter www.gemeinde.bozen.it > Beobachtungsstelle für Sozialpolitik und Lebensqualität und unter der Sektion Home > Dienste > I servizi per > Im Dienste von: > Bürger mit migratorischem Hintergrund und EU-Bürger > Publikationen heruntergeladen werden.

Parathënie

Ky udhëzues në shumë gjuhë, i cili ka lindur në sajë të një bashkë-financimit nga Sherbimi i Koordinim për Integrimin të Provincës së Bolzanos, përmban informacione të dobishëme për qytetarët, në veçanti për qytetarë me origjinë të huaj dhe persona të angazhuar në fushën e emigracionit.

Qëllimi i udhëzuesit është të lehtësojë mardhëniet e qytetarëve me institucionet vendore, për të përmirësuar përdorimin e shërbimeve publike në qytetin e Bolzanos.

Për qytetarët nuk është gjithmonë e thjeshtë ku e kujt ti drejtohen, çfarë të kërkojnë ose çfarë shërbimi është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

Shpresa që kemi është që ky manual të bëhet një mjet i dobishëm për të gjithë lexuesit dhe në të njëjtën kohë të lehtësojë procesin e integrit, për një bashkëjetesë paqësore.

I bindur se çdo shërbim mund të përmirësohet vetëm në sajë të sugjerimeve të përdoruesve, i mirëpresim me vëmendje këshillat tuaja për përmirësimin e këtij udhëzuesi shumëgjuhësh.

Dott. Juri Andriollo

*Këshilltar Bashkiak për Politikë Sociale
osservatorio@comune.bolzano.it*

INDEKS

1. Hyrja dhe qëndrimi

- 1.1. Vizat për hyrjen – 6
- 1.2. Leja e qëndrimit – 6
- 1.3. Lejet e qëndrimit "CE" për qëndrues për periudhë të gjatë ish karta e qëndrimit për të huaj – 10
- 1.4. Marrëveshje integrimi për të huajin që kërkon leje qëndrimi – 12
- 1.5. Bashkimi familjar – 13
- 1.6. Kthimi, ekspulsi, mbajtja – 19

2. Rezidenca, karta e identitetit, kodi fiskal, patenta, autoçertifikimi përkthimi dhe legalizimi i dokumentave

- 2.1. Regjistrimi në gjëndjen civile dhe rezidenca – 22
- 2.2. Karta e identitetit – 22
- 2.3. Karta provinciale e shërbimeve (karta e shëndetit – kodi fiskal) – 23
- 2.4. Patenta (leja e drejtimit të mjeteve) – 25
- 2.5. Dokumenta të identifikimit – 25
- 2.6. Autocertifikimi – 26
- 2.7. Përkthimi dhe legalizimi i dokumentave – 26

3. Azili politik, refugjati politik dhe lejet e qëndrimit për arsye humanitare

- 3.1. Azili politik dhe refugjatët politik – 27

4. Shtetësia

- 4.1. Atribuim automatik – 31
- 4.2. Shtetësia për shkak të përfitimit nga ligji – 31
- 4.3. Natyralizimi – 31

5. Punësimi

- 5.1. Punësimi për shtetasit e huaj të cilët zotërojnë një leje qëndrimi – 33
- 5.2. Puna për kë vjen nga jashtë shtetit – 33
- 5.3. Puna autonome – 37
- 5.4. Mbështetja shoqërore: ndihma familjare, pensioni, rimarrja e kontributeve në rast kthimi në atdhe – 38

6. Asistenca shëndetsore

- 6.1. Regjistrimi në shërbimin shëndetsor kombëtar – 40
- 6.2. Amësia dhe femijëria – 43
- 6.3. Parandalimi i shtatëzanisë nëpërmjet Kontraceptivëve – 44
- 6.4. Ndërpërja e shtatëzanisë – 44
- 6.5. Konsultorët familjare – 45

7. Asistenca socialo-ekonomike

- 7.1. Qendrat e shërbimit social: komunitetet ndihmëse dhe qendrat shëndetësore të bolzano-s – 46
- 7.2. Distrikti socio-shëndetsor – 47
- 7.3. Shërbimet e distriktit – 47

8. Shtëpia dhe strehimi

- 8.1. Banesa me qira – 51
- 8.2. Banesa sociale – 51
- 8.3. Ndihme ekonomike për pagesën e qirase dhe për shpenzimet aksesore – 52
- 8.4. Shtëpitë hotel – 53
- 8.5. Blerja e shtëpisë – 54

9. Shkollimi dhe universiteti

- 9.1. Regjistrimi shkollor – 56
- 9.2. Çerdhja – 56
- 9.3. Kopshti për fëmijët – 57
- 9.4. Shkolla fillore (elementare) – 60
- 9.5. Shkolla dytësore e gradës së parë (e mesme e ulët) – 60
- 9.6. Shkolla të mesmë të gradës së dytë (gjimnazi -liceu) – 60
- 9.7. Universiteti – 61
- 9.8. Formimi i të rriturve – 62
- 9.9. Njohja e titujve të studimit të marra jashtë shtetit – 62
- 9.10. Njohja e titujve për ushtrimin e profesionit – 62
- 9.11. Parashikime të veçanta për profesionet në fushën e shëndetësisë – 63

10. Formimi profesional

- 10.1. Tipologjitë e formimit – 64

11. Mbrojtja e të drejtave

- 11.1. E drejta për tu mbrojtur – 67
- 11.2. Mbrojtja falas – 67
- 11.3. Mbrojtësi civil - ombudsmani – 67
- 11.4. Parashikime në favor të të miturve – 67
- 11.5. Masa kundër diskriminimit racor – 68

12. Kultura, edukimi kultura e përbashkët

- 12.1. Qendra për zhvillimin e kulturës – 70
- 12.2. Edukimi ndërkulturor – 70
- 12.3. Bashkëpunimi drejt zhvillimit – 70

1. Hyrja dhe qëndrimi

1.1. VIZAT PËR HYRJEN

PËR KË?

Të gjithë shtetasit që konsiderohen të huaj, domethënë:

- Shtetasit e Shteteve jo Komunitare
- Shtetasit pa shtetësi (Apolidë)

Disa shtetas jo komunitarë mund të hyjnë në Itali ose në zonën Shengen pa vizë deri në një maksimum prej 90 ditësh në bazë të marrëveshjeve dy palëshë.

Viza është një autorizim i lëshuar nga ambasada italiane ose nga konsullata italiane e vëndit të banimit (rezidencës) të shtetasit të huaj e cila lejon hyrjen në Itali.

Në hyrjen në kufi të huajt i nënshtrohen kontrollit doganor ku autoritetet kufitare vulosin pasaportën me datën dhe vëndin e tranzitit (hyrjes).

LLOJET E VIZAVE (LLOJET MË TË ZAKONSHME)

- Viza për arsye studimi/formimi profesional: ka vlefshmëri të barabartë me atë të kursit që dëshirohet të ndiqet në Itali.
- Viza për bashkim familjar: ka vlefshmëri një vit nga lëshimi i saj; i lëshohet familjarëve që do të bashkohen pas lëshimit të lejes përkatëse.
- Viza për arsye pune si punëmarrës (me kohë të pa caktuar, me kohë të caktuar, stinore): merret vetëm pas lëshimit të lejes për punë.
- Viza për punë autonome jo okazionale. Për të patur këtë vizë duhen plotësuar kriteret profesionale dhe morale sipas kërkesave të ligjit të shtetit, sikur ato që i këkohen shtetasve italian për ushtrimin e të njëjtit aktivitet.
- Viza për turizëm lejon hyrjen në Itali ose në hapësirën Schengen shtetasve të huaj që udhëtojnë për turizëm, për një maksimum kohor deri në 90 ditë.

1.2. LEJA E QËNDRIMIT

PËR KË?

Mund të qëndrojnë në Itali, të huajt që kanë bërë hyrje të rregullt në territorin e shtetit, përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare.

Leja e qëndrimit duhet t'i kërkohet Kuestorit të Provincës ku i huaji gjëndet brenda 8 ditëve pune nga hyrja e tij në Itali¹.

Shtetasit e huaj mbi 16 vjeç, të cilët hyjnë në Itali për herë të parë, njëkohësisht me kërkesën për lejen e qëndrimit, nënshkruajnë me shtetin italian **Marrëveshjen e integritetit**.

Të huajt të cilët kanë bërë kërkesë nëpërmjet **zyrave të postës** do të thirren nga **zyra e migrimit** për t'ju nënshtruar marrjes së gjurmëve nëpërmjet metodave foto-datiloskopike dhe për dorëzimin e lejes së qëndrimit.

Kërkesa për pajisjen me Leje Qëndrimi "CE" për qëndrim për periudhë të gjatë, për vete dhe për familjarët në ngarkim, duhet të paraqitet me një "Kit" (kërkesë) të vetme.

Rinovimi i lejes së qëndrimit paraqitet nga nga i huaji tek Kuestori i Provincës ku i huaji banon. Për lejet e qëndrimit për arsye pune dhe arsye familjare me **kohëzgjatje dy vjeçare**, kërkesa paraqitet brenda afatit prej 90 ditësh përpara skadencës. Kërkesa për lejet e qëndrimit për arsye pune vjetore paraqitet brenda gjashtëdhjetë ditëve përpara skadencës dhe për të gjitha tipologjitë/llojet e tjera të lejeve të qëndrimit kërkesa paraqitet brenda tridhjetë ditëve.

Kohëzgjatja e lejes së qëndrimit

Për lejet e qëndrimit të cilat nuk janë lëshuar për arsye pune apo familjare, kohëzgjatja është ajo e parashikuar nga viza e hyrjes.

Kohëzgjatja nuk mund gjithsesi të jetë:

- mbi tre muaj për **biznes dhe turizëm**;
- mbi një vit, në lidhje me **frekuentimin e një kursi studimi** ose formimi profesional. Leja e qëndrimit është e rinovueshme çdo vit në rastin e kurseve të studimit shumëvjeçar;
- mbi dy vite për **punë autonome/te pavarur**, për **punë si punëmarrës** me kohë të pa caktuar ose për bashkim familjar.

Ndërrimi i arsyes së lejes së qëndrimit

Për të ndryshuar llojin e lejes së qëndrimit të cilën disponon, duhet të kërkohet leja (nulla osta) tek Sporteli Unik (Sportello Unico) për Migrimin në Kuesturë. Kusht për konvertimin është që të ketë kuota hyrje të parashikuara nga dekreti mbi flukset (Decreto flussi) si dhe që leja e

.....

1 Për shtetasit të cilët u përkasin një shteti anëtar të Bashkimit Europian paraqitja e kërkesës për leje qëndrimi (carta di soggiorno) pranë zyrave të postës është fakultative, gjithsesi ato mund t'i drejtohen këtyre zyrave dhe Zyrave të migracionit pranë Kuesturave. 8-të ditët e punës duhet të llogariten duke përfshirur ditët e diela dhe ditët pushim

qëndrimit në posedim te jetë e vlefshme.

***KUJDES. – Dekreti mbi flukset nuk del me rregullsi vjetore!**

Leja e qëndrimit për **arsye studimi/formimi profesional** mund të shndërrohet në leje qëndrimi për arsye pune si punëmarrës ose autonome nëse plotësohen kërkesat e parashikuara për këtë tipologji leje qëndrimi.

Leja e qëndrimit për **punë stinore** mund të shndërrohet në leje qëndrimi për punë si punëmarrës me kohë të pacaktuar ose me kontratë për të paktën një vit kur:

- I huaji ka bërë hyrje në Itali për punë stinore për të dytin vit rradhasi dhe posedon një leje qëndrimi të vlefshme;
- I huaji ka bërë hyrje në Itali për punë stinore dhe në përfundim të periudhë së parë të punës stinore të lejuar posedon një leje qëndrimi të vlefshme.

SI?

Kërkesat për lëshim dhe rinovim të lejes së qëndrimit për shtetasit jo komunitarë të cilët i përkasin këtyre tipologjive duhet të paraqiten nga i interesuari pranë Zyrave Postale të liçensuara duke përdorur Kitin e posaçëm me vijë të verdhë i cili gjëndet në të gjitha zyrat e postës, Patronatet dhe Bashkitë².

Mund të paraqiten pranë **Zyrave Postale** kërkesat në lidhje me tipologjitë e mëposhtme të lejeve të qëndrimit:

- Birësim dhe Kujdestari
- Azhornim dhe duplikate e lejes së qëndrimit “CE” për qëndrim për periudhë të gjatë dhe azhornim të lejes së qëndrimit (ndryshim vend qëndrimi, gjëndjës civile, vendosjen e femijëve, ndryshim pasaporte)
- Pritje për punësim
- Pritje për rimarrje shtetësie
- Azil politik
- Leje “CE” për qëndrim për periudhë të gjatë
- Konvertim i Lejes së Qëndrimit
- Duplikatë e Lejes së Qëndrimit
- Familje
- Punë Autonome
- Punë si punëmarrës
- Punë sipas rasteve të veçanta
- Punë si punëmarrës - stinor
- Mision

2 Në momentin e prezantimit të kërkesës i huaji duhet të kryej pagesën sipas shumave të parashikuara sipas dekretit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

- Arsye fetare
- Rezidencë elektive
- Kërkim shkencor
- Rinovim i statusit të pashtetësisë
- Studim
- Kurs formimi profesional
- Turizëm
- Karta Blu UE

Kërkesa për lëshim dhe rinovim të të gjitha tipologjive të tjera të lejeve të qëndrimit – kartave të qëndrimit, duhen bërë pranë Zyrave të Migrimit pranë Kuesturës sipas kompetencës territoriale.

Për plotësimin e modularëve i huaji mund të asistohet falas nga Patronato. Në momentin e paraqitjes së kërkesë pranë sportelit të zyrës postale të abilituar, i huaji do të identifikohet nëpërmjet pasaportës ose dokumenti tjetër të barazvlefshëm.

Kërkesa duhet prezantuar në **Zarf të hapur**, e cila nuk do të mund të kontrollohet nëse më parë nuk është nënshkruar nga i interesuari;

Konfirmimi i pranimit të kërkesës (**ricevuta**) e cila i lëshohet të huajit në momentin e paraqitjes së kërkesës, përmban **kodet e aksesit tek zona e rezervuar** për të njohur stadin e avancimit të praktikës.

Në rastin e kërkesës për rinovim të lejes së qëndrimit, është e domosdoshme vendosja në zarf e fotokopjes së lejes së qëndrimit që duhet rinovuar apo azhurnuar.

KU?

Kuestura e Bolzano - S

Divizioni P.A.S.I. - Zyra. Policia e Migrimit dhe e të Huajve

Largo Giovanni Palatucci n. 1, 39100 Bolzano

Telefon: 0471 94 76 16

Email: immig.quest.bz@pecps.poliziadistato.it

Të Hënën: 8:30-12:00

Të Martën: 8:30-12:00

Të Mërkurën: 8:30-12:00

Të Enjten: 8:30-12:00 / 15:00-17:00

Të Premten: 8:30-12:00

Posta Italiane

Bolzano Qëndër

Adresa: Piazza della Parrocchia, 13, 39100 Bolzano

Telefon: 0471 32 22 60

Fax: 0471 32 22 40

Bolzano 5

Adresa: Viale Amedeo Duca D'Aosta, 104, 39100 Bolzano

Telefon: 0471 47 37 11

Fax: 0471 40 13 11

1.3. LEJET E QËNDRIMIT "CE" PËR QËNDRUES PËR PERIUdhË TË GJATË ISH KARTA E QËNDRIMIT PËR TË HUAJ

Shtetasi i huaj i cili jeton ne menyre të rregullt në Itali prej të paktën 5 vitesh, i cili mendon të kërkojë **lejen e qëndrimit "CE" për qëndrues për periudhë të gjatë** (neni 9 T.U. immigracionit)³ duhet të kryej dhe të kalojë **testin e njohjes së gjuhës Italiane**.

Për të kryer testin duhet të dërgojë në Prefekturën e Provincës ku banon një kërkesë nëpërmjet procedurës informatike aktive në faqen web të dedikuar <https://nullaostalavoro.dlci.interno.it> ⁴

Përfashtonhen nga testi:

- Fëmijët minor nën 14 vjeç;
- Personat me deficit të rëndë në të përthithurin e gjuhës të çertifikuar nga një strukturë shëndetësore publike.

Nuk është i detyruar të kryej testimin i huaji i cili sipas nenit 3 plotëson kushtet e mëposhtme:

- a. posedon dëshmi apo tituj të cilët dëshmojnë njohjen e gjuhës italiane në një nivel jo më të ulët se **A2** sipas Kuadrit Komun të Referimit European për njohurinë e gjuhëve;
- b. ai i cili ka marrë **kredite të maturuara sipas marrëveshjes për integrimin**;
- c. ai i cili ka marrë **diplomën e shkollës së mesme të nivelit të parë apo të dytë** pranë një instituti shkollor i cili i përket sistemit italian të shkollimit, ose frekuenton një kurs studimesh pranë një Universiteti italian shtetëror ose jo shtetëror të njohur ligjërisht, ose frekuenton në itali kursin për doktoraturën ose një master universitar;
- d. i huaji, i cili ka hyrë në itali si: **drejtues ose punonjës me kualifikim të lartë**.

.....

- 3 Leja e qëndrimit e BE për banorët afatgjatë nuk mund t'u lëshohet të huajve që konsiderohen të rrezikshëm për rendin publik ose sigurinë e shtetit.
- 4 Në faqen e internetit mund të konsultohet rezultati i testit tuaj. Sistemi kompjuterik merr kërkesën tuaj dhe e dërgon atë në zyrën kompetente, e cila një herë verifikon rregullsinë e aplikimit duke thirrur brenda 60 ditëve aplikuesin, duke treguar datën dhe vendin e provimit. Në rast të një rezultati pozitiv të testit, prefektura e komunikojë këtë në mënyrë elektronike në selinë e policisë së provincës e cila, pasi ka verifikuar ekzistencën e kërkesave të tjera ligjore, lëshon lejen e qëndrimit. Në rast të një rezultati negativ, shtetasi i huaj mund të kërkojë, duke përdorur të njëjtën procedurë, ta përsërisë testin, vetëm pas 90 ditëve nga data e ekzaminimit të mëparshëm.

SI?

Leja e qëndrimit "CE" për qëndrues për periudhë të gjatë mund të kërkohet nga i huaji titullar i Lejes së qëndrimit për një arsye e sila lejon një numër të pa caktuar rinovimesh (familje, punëmarrës më kohë të pa caktuar, punë autonome, azil politik, rezidencë elektive, arsye fetare, status pashtetësie), i cili qëndron rregullisht në Itali prej të paktën 5 vitesh;

Për kërkesën e të huajit të vetëm dhe pa familjar në ngarkim në Itali, të ardhurat nuk duhet të jenë nën minimumin vjetor të parashikuar nga ndihma sociale⁵ (assegno sociale);

Leja e qëndrimit "CE" për qëndrues për periudhë të gjatë mund të kërkohet edhe nga bashkëshorti dhe fëmijët minor bashkëjetues të të huajit kërkuar. Në këtë rast i huaji duhet të tregojë që posedon të ardhura të mjaftueshme për jetesën e tij dhe të familjarëve.

Bashkëshorti dhe fëmijët minorë mbi katëmbëdhjetë vjeç bashkëjetues me të huajin i cili kërkon Lejen e qëndrimit "CE" për qëndrues për periudhë të gjatë duhet të plotësojnë një modul të vetin, moduli 1 (ose edhe modulin 2 nëse ka të ardhura të vetat individuale);

Leja e qëndrimit "CE" për qëndrues për periudhë të gjatë mund të kërkohet edhe nga i huaji bashkëshort ose fëmijë i mitur ose prind bashkëjetues i një shtetasi italian ose shtetasi të një shteti të Bashkimit Europian rezident në Itali. Në këtë rast kërkesa duhet plotësuar vetëm me dokumentat e gjëndjes civile të cilat vërtetojnë raportin në familje dhe lidhjen e gjakut (si Psh; fëmijë, prind, etj);

Leja e qëndrimit "CE" për qëndrues për periudhë të gjatë ⁶ përbën një dokument identifikimi personal për jo më shumë se pesë vjet nga data e lëshimit ose rinovimit. Rinovimi kryhet me kërkesë të palës së interesuar, shoqëruar me fotografi të reja.

ÇFARË?

(neni 9 e Dekret Ligjit nr. 286/98 dhe ndryshimet e mëtejshme. neni. 16e 17 del D.P.R. n 394/99 dhe ndryshimet e mëtejshme.)

- Aplikimi i plotësuar dhe i nënshkruar nga pala e interesuar (Formulari 1 dhe 2);

.....

- 5 Në rastet kur ligji nuk kërkon paraqitjen e deklaramit të të ardhurave (për shembull punëtorët në shtëpi) të ardhurat mund të vërtetohen me dokumentacion tjetër objektiv si psh. (paga, kontribute INPS);
- 6 Leja e qëndrimit "CE" për banorët me afat të gjatë nuk mund t'i lëshohet të huajit për të cilin është vendosur për ndonjë nga krimet sipas nenit. 380 k.p.p. si dhe, të kufizuara në krimet e kryera pa faj të parashikuara në nenin. 381 k.p.p., ose në rastin e vendimit të denimit edhe nëse nuk është përfundimtar, përveç nëse ka marrë rehabilitim. Revokimi i lejes së qëndrimit urdhërohet nëse është dhënë një dënim edhe nëse nuk është përfundimtar, për veprat e lartpërmendura.

- Fotokopja e të gjithë pasaportës ose dokument tjetër ekuivalent (shih tabelën nr. 4);
- Fotokopja e deklaratës mbi të ardhurat ose modeli **CUD**, i lëshuar nga punëdhënësi, në lidhje me vitin paraardhës;
- Çertifikata e të dhënave penale dhe çertifikata e regjistrimeve të lidhura me procese penale në vazhdim;
- Kërkesa për një kartë qëndrimi edhe për fëmijët e mitur mbi moshën 14 vjeçare, duhet të shoqërohet me:
 - Fotokopje e të dhënave personale që vërtetojnë statusin e gjendjes civile të fëmijës së mitur. Nëse vjen nga jashtë shtetit, çertifikimi duhet të përkthehet, legalizohet dhe vërtetohet nga përfaqësia diplomatike konsullore italiane, përveç nëse parashikohet ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare. Ky dokumentacion nuk kërkohet nëse i mituri ka hyrë me një vizë për bashkim familjar.
 - Fotokopja e certifikatës së përshtatshmërisë së strehimit sipas nenit. 29 paragrafi 3, germa a), Dekreti Legjislativ n. 286/98 dhe ndryshimet pasuese.

KU?

Shiko Seksionin 1.2

1.4. MARRËVESHJE INTEGRIMI PËR TË HUAJIN QË KËRKON LEJE QËNDRIMI

“Rregullorja në lidhje me rregullimin e marrëveshjes së integrimit midis të huajit dhe shtetit” hyri në fuqi më 10 mars 2012 dhe prej asaj date të huajt, mbi 16 vjeç, të cilët do të hyjnë në territorin kombëtar Italian për për herë të parë dhe do të kërkojnë leje qëndrimi për një periudhë jo më pak se një vit, duhet të nënshkruajnë këtë marrëveshje në Prefekturë ose në Kuesturë⁷.

Marrëveshja është e ndarë në kredi, ka një kohëzgjatje prej dy vjetësh dhe mund të zgjatet me një. Në përfaqësimin e shtetit, ajo nënshkruhet nga Prefekti ose nga i deleguari prej tij.

Me nënshkrimin e saj, i huaji merr përsipër të fitojë një nivel të përshtatshëm të njohurive të gjuhës së folur italiane ose gjermane⁸ (të paktën në nivelin A2 të kornizës së përbashkët europiane të referencës),

7 Me këtë institut u vendos që të ndiqet rruga e paktit me qytetarin që nuk i përket Bashkimit Evropian si rezident i ligjshëm, bazuar në angazhimet e ndërsjella. Nga ana e Shtetit, për të siguruar gëzimin e të drejtave themelore dhe për të siguruar mjetet që mundësojnë marrjen e gjuhës, kulturës dhe parimeve të Kushtetutës italiane; nga ana e shtetasve të huaj, angazhimin për të respektuar rregullat e shoqërisë civile, për të ndjekur, në interes të përbashkët, një rrugë të rregullt të integrimit.

8 Për territorin e Provincës Autonome të Bolzano-s.

një njohuri të mjaftueshme të parimeve themelore të Kushtetutës së Republikës, të kulturës qytetare dhe të jetesës në mënyrë civile në Itali si dhe aty ku është e pranishme, për të garantuar përmbushjen e detyrimit të arsimimit të fëmijëve të mitur.

Për ta quajtur marrëveshjen e plotësuar, në aktin e verifikimit, i huaji duhet të marrë së paku **tridhjetë kredite**⁹ që domosdoshmërisht përfshijnë nivelet minimale të njohjes së italishtes dhe / ose gjermanishtes (për Proivincën e Bolzanos) dhe të jetës civile dhe sociale në Itali.

Në momentin e aplikimit, të huajt i jepen 16 kredite dhe mundësia të ndjekë brenda 90 ditëve nga data e nënshkrimit, një kurs falas të trajnimit qytetor me kohëzgjatje prej 10 orësh pranë **Qendrave për Arsimin e të Rriturve ose pranë Qendrave Territoriale të Përhershme (CTP)**.

KU?

Qendra gjuhësore: <http://www.provincia.bz.it/formazione-lingue/lingue/migrazione-alfabetizzazione.asp>

1.5. BASHKIMI FAMILJAR

Përbërja familjare:

“Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtë të mbrohet nga shoqëria dhe shteti”

(Deklarata Universale e të Drejtave të Njëriut)

Uniteti familjar është një e drejtë themelore e njohur dhe e mbrojtur nga sistemi juridik italian¹⁰.

Leja e qëndrimit për arsye familjare lëshohet:

- të huajt që ka hyrë në Itali, me një vizë hyrje për bashkim familjar, ose me një vizë hyrje si anëtar i familjes që e shoqëron me vete atë;
- për të huajt që jetojnë në mënyrë të ligjshme për të paktën një vit në territorin italian, të cilët kanë një kontratë martesore në territorin e

9 Në disa raste - të tilla si, për shembull, për kryerje të një krimi apo shkelje të rënda të ligjit - kreditet gjithashtu mund të reduktohen dhe / ose të humbasin. Nëse numri i kredive përfundimtare është i barabartë ose më i madh se pragu i pajtueshmërisë, i përcaktuar - siç u tha më lartë - në tridhjetë kredite, dekretohet ndërprerja e marrëveshjes për shkak të përmbushjes së saj si dhe lëshohet certifikata përkatëse.

10 Bashkimi familjar është një mjet thelbësor për të lejuar jetën familjare, pasi ajo ndihmon në krijimin e një stabiliteti socio-kulturor që lehtëson integrimin në shtet, duke lejuar kështu promovimin e kohezionit ekonomik dhe social.

shtetit me qytetarë italianë ose me një shtetas të Bashkimit Evropian, ose me shtetas të tjerë të huaj të cilët kanë qëndrim të ligjshëm. Mos bashkëjetesa passjell revokimin e lejes së qëndrimit për arsye familjare, përveç nëse dy bashkëshortët kanë pasur fëmijë pas martesës.

- prindit të huaj edhe atij natyral, të një fëmije italian me banim në Itali, me kusht që ai të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të autoriteti prindëror sipas ligjit italian.

Leja e qëndrimit për arsye familjare lëshohet për një kohëzgjatje të barabartë me lejen e qëndrimit të anëtarit të familjes së huaj që ka kërkuar bashkimin familjar.

Pasja e lejes së qëndrimit për arsye familjare lejon hyrjen në shërbimet e mirëqenies sociale, regjistrimin në kurse studimi ose aftësim profesional dhe kryerjen e punë si punëmarrës ose atyre autonome brenda kufijve të moshës të përcaktuara nga ligji italian.

Në rastin e vdekjes së anëtarit të familjes në zotërim të kërkesave për bashkim familjar dhe në rast të ndarjes ligjore ose zgjidhjes së martesës, leja e qëndrimit mund të konvertohet në prani të plotësimit të kërkesave ligjore në leje për punë ose studim.

Së fundmi, sigurohet mbrojtje e shtuar kundër largimit nga territori i Shtetit, ndaj të të huajt i cili ka ushtruar të drejtën e bashkimit familjar, ku i imponohet administratës që të vlerësojë konkretisht situatën e palës së interesuar, duke marrë parasysh edhe rrezikshmërinë e saj për sigurinë dhe rendin publik, si dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tij dhe lidhjet e tij familjare dhe shoqërore.

SI?

Hyrja e anëtarëve të familjes së të huajve që banojnë ligjërisht në Itali është subjekt i lëshimit të vizës për bashkim familjar.

Viza e hyrjes duhet të kërkohet nga i huaji që banon rregullisht në Itali, duke paraqitur kërkesën për leje për t'u ribashkuar në **Sportelin Unik të Migracionit**, duke përdorur procedurën kompjuterike të disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme.

Prej 17 gushtit 2017, procedura për paraqitjen e kërkesës për bashkim familjar është tërësisht digjitale përmes faqes së internetit <https://nullaostalavoro.dlci.interno.it/Ministero/Index2>, tani ajo duhet të shoqërohet gjithashtu me dokumentacionin që ka të bëjë me plotësimin

e kërkesave për të ardhurat dhe strehim¹¹, dokumenta këto të skanuara nga personi i interesuar te cilat dërgohen si një shtojcë bashkëlidhur në kërkesën për ribashkim.

Risja do ti lejojë Sportelit Unik të Migracionit verifikimin e plotësimit e kërkesës e në lidhje me strehimin dhe të ardhurat dhe vazhdimin e procedurës për lëshimin e autorizimit brenda 90 ditëve - afati kohor i vendosur nga ligji - nga paraqitja e kërkesës.

PËR KË?

I huaji që dëshiron të aplikojë për bashkim familjar duhet të ketë në posedim një **leje qëndrimi të vlefshme për të paktën një vit** ose për të cilën është kërkuar rinovimi brenda afatit të lejuar, leja duhet të jetë e lëshuar për arsye punësimi si punëmarrës ose të vetëpunësim ose për azil politik, studime, arsye fetare ose familjare.

Lëshimi i vizës dhe marrja e mëvonshme e lejes për bashkim familjar janë subjekt i verifikimit të ekzistencës së disa kushteve. I huaji që jeton ligjërisht në Itali duhet në fakt të demonstrojë disponueshmërinë e:

- **Një banesë të përshtatshme**, të pajisur me kushte higjienike dhe sanitare, të vërtetuar me certifikatën e përshtatshmërisë së banimit. Pala e interesuar duhet të kërkojë certifikatën përkatëse në Zyrën Teknike të Bashkisë së banimit¹².

Kërkesat në lidhje me përshtatshmërinë e banesës:

Sipërfaqe për banor:

- 1 banor: 14 metra katrorë
- 2 banor: 28 metra katrorë
- 3 banor: 42 metra katrorë
- 4 banor: 56 metra katrorë
- Për çdo banor shtesë + 10 metra katrorë

Përbërja e banesës:

- Dhomë gjumi për 1 person: 9 metra katrorë
- Dhomë gjumi për 2 persona: 14 metra katrorë + një dhomë ndënjë 14 metra katrorë

.....

11 Sikur parashikohet nga neni. 29, paragrafi i 3 i tekstit unik për emigracionin.

12 Nëse personi që kërkon ribashkimin është një mysafir, ai gjithashtu duhet të shoqërojë kërkesën për ribashkim me deklaratën e hartuar nga pronari i banesës, sipas modelit S2, nga i cili paraqitet edhe pëlqimi për të strehuar anëtarin e familjes ose anëtarët e familjes. Në rast të ribashkimit në favor të vetëm një të miturve nën moshën 14 vjeç, certifikata e komunës mund të zëvendësohet me një deklaratë mikpritje të pronarit të banesës sipas modelit S1. Aplikanti duhet gjithashtu ti bashkëngjisë kërkesës një kopje të marrëveshjes së qirasë ose të huasë ose të pronës së ndërtesës, që zgjat jo më pak se gjashtë muaj, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës.

Për banesa me një dhomë (MONOLOKAL):

- 1 person: 28 metra katrorë (përfshirë edhe banjën)
- 2 persona: 38 metra katrorë (përfshirë edhe banjën)

Lartësia minimale:

- 2,70 metra

Ajrim i përshtatshëm:

- Sallon dhe kuzhina me dritatare që mund të hapet.
- Banjo, kur nuk ka dritare që mund të hapet duhet të jetë e pajisur me impiant aspirimi mekanik.
 - Të ardhura minimale vjetore¹³ që rrjedhin nga burime të ligjshme dhe jo më pak se shuma vjetore e ndihmës sociale e rritur me gjysmën e shumës së ndihmës sociale për secilin anëtar të familjes që dëshiron të bashkohet. Ky parametër i të ardhurave është subjekt i azhurnimit vjetor dhe rritja e nevojshme e të ardhurave varet nga numri i anëtarëve të familjes që synohet të bashkohen¹⁴.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet për të vërtetuar disponueshmërinë e të ardhurave varion sipas llojit të profesionit ose punës së kryer nga aplikanti. Për qëllime të përcaktimit të të ardhurave, merren parasysh gjithashtu edhe të ardhurat vjetore të përgjithshme të anëtarëve të familjes që bashkëjetojnë me aplikantin.

Nuk është e nevojshme të demonstrohet plotësimi i kriterëve të përshtatshme për strehim dhe të ardhura për azilkërkuesit dhe refugjatët.

PËR KË?**Anëtarët e familjes që mund të ribashkohen:**

I huaji në Itali mund të kërkojë ribashkimin e anëtarëve vijuese të familjes jashtë vendit:

- **Bashkëshortin**¹⁵ i cili ka mbushur 18 vjeç dhe me të cilin banori në Itali nuk është i ndarë ligjërisht.
- **Fëmijët** të cilët në kohën e aplikimit për bashkim janë nën moshën 18 vjeç edhe fëmijët e bashkëshortit ose ato të lindur jashtë martesës, me kusht që të mos jenë të martuar dhe se prindi tjetër (nëse ka) ka

.....

13 Nëse do ribashkohen dy ose më shumë fëmijë nën moshën 14 vjeç, të ardhurat minimale të kërkuara janë 11,778.00 €. Për çdo bashkim tjetër, përveç fëmijëve nën 14 vjeç (si psh: djemtë, bashkëshortët ose prindërit), përtej shumës prej 11,778.00 euro, duhet të shtohet për secilin person shuma prej 2,944.50 euro.

14 Për shembull, për vitin 2018, aplikanti që jeton rregullisht në Itali, i cili dëshiron të ribashkohet me bashkëshortin dhe fëmijën e tij / saj duhet të ketë të ardhura prej 11,778 € (5,889 € + 2,944.50 + 2,944.50 €).

15 Një i huaj që banon ligjërisht në Itali nuk mund të aplikojë për bashkim familjar për bashkëshortin, nëse ai është i martuar me një bashkëshort tjetër që banon në Itali.

shprehur pëlqimin e tij. Fëmijët e mitur të adoptuar ose të besuar për rritje dhe edukim barazohen me fëmijët e tjerë.

- **Fëmijët e rritur** të cilët janë në ngarkim të të huajit që banon në Itali, kur ata, për arsye objektive, nuk mund të sigurojnë nevojat jetësore të domosdoshme për arsye të rënda shëndetësore që përfshijnë paaftësi totale.
- **Prindërit në ngarkim** të të huajit që banon në Itali ose prindërit mbi moshën 65 vjeç, kur nuk ka fëmijë të tjerë të cilët janë në gjendje të sigurojnë mbështetjen e tyre në vendin e origjinës ose prejardhjes ose nëse fëmijët e tjerë nuk mund ta bëjnë këtë për arsye serioze shëndetësore të dokumentuara.
- Në rastin e prindërve mbi moshën 65 vjeç, kërkohet edhe sigurimi shëndetësor ¹⁶.

Lejohet gjithashtu hyrja për bashkim familjar e prindit natyral të të miturit i cili banon në mënyrë të lighshme në Itali me prindin tjetër¹⁷.

Si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 118/2016, që rregullon **bashkimin civil midis personave të së njëjtës gjini**, rregullat mbi bashkimin familjar shtrihen edhe mbi shtetasit e huaj të së njëjtës gjini të lidhur civilisht (unione civile) midis tyre, ose me shtetas italian¹⁸.

SI?

Nëse kërkesa pranohet, **Zyra e Unike për Migracionin** lëshon autorizimin për ribashkim, duke dërguar në mënyrë elektronike drejtpërsëdrejti në **Zyrën Konsullore Italiane** të vendit të origjinës ose vendbanimit të anëtarit të familjes i cili do të ribashkohet dhe gjendet ende jashtë vendit, duke hapur fazën e dytë të procedurës për verifikimin e kërkesave subjektive për lëshimin vizës hyrëse.

Duhet paraqitur pranë zyrave Konsullore:

- Kërkesa për lëshimin e një vize hyrjeje,
- Çertifikimi që vërteton marrëdhënien familjare, të përkthyer dhe legalizuar.
- Në rast se çertifikimi i kërkuar nuk është i disponueshëm për shkak

.....

16 Kur paraqitet kërkesa për bashkim, mjafton të paraqitet një deklaratë e angazhimit për të nënshkruar një politikë sigurimi. Kjo duhet të nënshkruhet brenda 8 ditëve nga hyrja në territorin e Shtetit dhe përpara paraqitjes në Sportelin Unik të Migracionit, ku duhen respektuar kushtet mëposhtme: sigurimi nuk duhet të ketë një datë të skadimit dhe duhet të mbulojë rreziqet e sëmundjeve, aksidenteve dhe lindjes.

17 Shih MINISTRIA E BRENDSHME, Rregullore e datës 17 Shkurt 2009, n. 737.

Shih: Vendimi i Gjykatës së Milanos, seksioni i punës, i 5 dhjetorit 2012: Është diskriminim mohimi ndaj prindërve mbi 65, të emigrantëve jo Komunitarë, të cilët hynë në Itali për bashkim familjar, të mundësisë së regjistrimit në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar.

18 Shih: Rregullorja e Ministrisë së Brendshme e 5 gushtit 2016, n. 3511

të mungesës së autoritetit kompetent të huaj ose nëse ky i fundit nuk paraqet besueshmërinë e nevojshme, përfaqësia diplomatike në vendin e origjinës (ose në çdo rast kompetente) së anëtarëve të familjes, lëshon dokumentacionin e lartpërmendur në bazë të verifikimeve që konsiderohen të nevojshme, duke përfshirë edhe ekzaminimin e ADN-së, ku shpenzimet do të jenë në ngarkim të palës së interesuar.

- Në rastin e fëmijëve të rritur, gjendja shëndetësore mund të dokumentohet me një certifikatë të lëshuar nga mjeku i emëruar nga përfaqësuesi diplomatik-konsullor italian, përgjegjës për vendin e origjinës së anëtarëve të familjes për të cilët kërkohet ribashkimi, ku shpenzimet do të jenë në ngarkim të aplikantit.

Nëse kërkesa refuzohet, kundër refuzimit është e mundur të bëhet ankim në Gjykatën e zakonshme të vendbanimit të aplikantit që banon në Itali në mënyrë të rregullt.

- Viza për bashkim me anëtarin e familjes për të cilin është lëshuar më parë autorizimi (nulla osta) lëshohet ose mohohet brenda 30 ditëve nga kërkesa.
- Nëse aplikanti mban statusin e refugjatit, refuzimi i kërkesës nuk mund të justifikohet vetëm nga mungesa e dokumenteve që dëshmojnë ekzistencën e lidhjeve familjare ose posedimin e kërkesave të tjera nga anëtarët e familjes.
- Brenda 48 orëve nga hyrja në Itali e anëtarit të familjes që ka marrë vizën për bashkim, anëtari i familjes që jeton rregullisht në Itali duhet të paraqesë deklaratën me shkrim të transferimit të bërë (cessione fabbricato) tek autoriteti i sigurisë publike.

Hyrja me familjar me vete

Nëse anëtari i familjes që plotëson kërkesat për bashkim dëshiron të hyjë në Itali në të njëjtën kohë me anëtarin e familjes që ka marrë tashmë një vizë hyrje (për punë si punëmarrës në lidhje me një kontratë që zgjat jo më pak se një vit ose për vetëpunësim jo të rastit, ose për studime ose për arsye fetare) mund të aplikojnë për një vizë hyrjeje për një anëtar të familjes së tij të cilin e shoqëron. Për të marrë këtë vizë është e nevojshme të plotësohen të njëjtat kushte për bashkimin familjar (që janë kërkesat e farefisnisë dhe disponueshmëria e akomodimit dhe të ardhurave).

Duhet të përdoret modeli T, duke përdorur procedurën kompjuterike të disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme.

Vetëm në këtë rast, i huaji posedues i lejes së qëndrimit që paraqet kërkesën e tij ende jashtë vendit mund të përdorë një përfaqësues të posaçëm në Itali për të paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës. Prandaj, në momentin e paraqitjes pranë Zyrës Unike të

Migrimit për paraqitjen e dokumentacionit të parashikuar për bashkimin familjar, ai gjithashtu duhet ti shtojë kërkesës së tij edhe sa më poshtë:

- Fotokopje të dokumentit të identitetit të përfaqësuesit të posaçëm.
- Prokurën (delega) në favor të një shtetasi italian ose të huaj me qëndrim të rregullt në Itali, me qëllim për paraqitjen e kërkesës për leje (nulla osta) për familjarë me vete, të përpiluar nga i huaji i cili ka tashmë një vizë, të përkthyer dhe legalizuar nga përfaqësia diplomatike apo konsullore italiane e vëndit të origjinës ose të rezidencës së kërkuar.

1.6. KTHIMI, EKSPULSI, MBAJTJA

Masat me të cilat shteti italian urdhëron largimin nga territori i saj i shtetasve të vendeve që nuk i përkasin Bashkimit Evropian dhe personave pa shtetësi të kualifikuar si të huaj në kuptimin teknik, sipas përkufizimit normativ (neni 1, pika 1, D. Lgjs 286/1998, më tutje TU) të cilat nuk kanë të drejtë të qëndrojnë në territorin italian, ndahen në dy kategori të mëdha: kthimet dhe dëbimet.

Kthimi

- a. Kthimi (neni. 10 T.U.) ndërrmerret nga Autoriteti Administrativ i Sigurisë Publike dhe mund të jetë dy llojesh:
 - kthim i menjëhershëm (neni. 10, paragrafi. 1, T.U.) i vendosur nga policia kufitare i cili ekzekutohet menjëherë;
 - kthim i mëvonshëm në kohë (neni. 10, paragrafi. 2, T.U.) i vendosur nga Kuestori.

PËR KË?

Për të huajt që paraqiten në pikat kufitare pa dokumente të vlefshme për hyrje në Itali. Të huajt refuzohen dhe kthehen në kufi:

- për ata që hyjnë në territorin e shtetit duke shmangur kontrollat kufitare
- për ata që nuk plotësojnë kërkesat për hyrje, edhe kur pranohen përkohësisht në territorin italian për shkak të nevojës për ndihmë të shpejtë.

Ndalimi i kthimit për¹⁹:

- Azil kërkuesit;
- Atij të cilit i njihet statusi i **refugjatit**;
- Kush përfiton nga masat për **mbrojtje të përkohshme për motive umanitare** ²⁰;
- **Minorenët** e pa shoqëruar.

Ekspulsi

Ekspulsi/Dëbimi ndahet në dy kategori në varësi të autoritetit i cili i lëshon:

1. **Nga autoriteti administrativ i sigurisë publike** në lidhje me të huajt që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme ose që konsiderohen të rrezikshme për sigurinë publike ose për rendin publik ose për sigurinë e shtetit (neni 13 i TU)
2. **Nga autoriteti gjyqësor**, si rezultat i procedimeve penale, të cilat janë të katër llojeve:
 - dëbimi si masë sigurie, e urdhëruar kundër të huajit të dënuar shoqërisht të rrezikshëm (neni 15 TU, kodi penal dhe ligjet e tjera);
 - dëbimi si masë alternative e paraburgimit të të ndaluarit të huaj në fazën e shlyerjes së dënimit përfundimtar, në dy vitet e fundit të ekzekutimit të dënimit (neni 16 TU);
 - dëbimi si sanksion zëvendësues, për të huajt në një situatë të qëndrimit të parregullt, i cili duhet të dënohet për një krim të kryer me burgim për një afat më të shkurtër se dy vjet (neni 16 TU);
 - dëbimi me anë të sanksioneve alternative të dënimit financiar (neni 16 TU) i zbatueshëm nga gjyqtari i paqes, në rast të dënimit për krimet e hyrjes dhe qëndrimit të paligjshëm (neni 10 bis TU) dhe mosplotësimit të urdhrit të largimit të Kuestorit. (neni 14, bashkë 5 ter quater, TU)

-
- 19 Dispozitat mbi refuzimet nuk zbatohen për aplikantët për azil politik, njohjen e statusit të refugjatit ose masat e mbrojtjes shtesë ose mbrojtjes për arsye humanitare (neni 10, paragrafi 6, T.U.). Në asnjë rrethanë refuzimi nuk mund të bëhet në një shtet në të cilin i huaji mund të jetë subjekt i persekutimit për arsye racore, gjinie, gjuhe, shtetësie, feje, mendimesh politike, kushteve personale ose sociale ose ku mund të kthehet në një shtet tjetër në të cilin nuk mund të mbrohet nga persekutimi (neni 19, paragrafi 1, TU).
 - 20 Natyrisht, këto garanci, që parashikohen në masë të konsiderueshme për mbrojtje ndërkombëtare zbatohen deri në rezultat në aplikimit përkatës dhe vetëm në rastin kur i huaji, i cili është në gjendje të refuzohet, domethënë të gjithë ata që zbarkojnë në brigjet italiane ose janë shpëtuar në det të hapur nga njësitë detare dhe janë dërguar në qendrat (hot-spot) - dhe janë vënë në pozitë për të shprehur dëshirën e tyre për të kërkuar mbrojtje. Dështimi për të informuar menjëherë për të drejtën për të kërkuar azil, ose transpozimi i vonuar i të drejtave të lartëpërmendura do të zhvleftësojnë faktikisht dispozitat që kanë të bëjnë me ndalimet e refuzimit, të cilat rrezikojnë të mbeten në letër.

ANKIMI

Dëbimet paraqesin një fakt shumë serioz: nëse merrni një dëbim ose nëse keni frikë se jeni në gjendje ta merrni atë, **drejtohuni menjëherë pramë zyrave të konsulencë dhe/ose zyrave ligjore.**

Kundër dekretit të dëbimit mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e zakonshme brenda 5 ditëve nga dita e komunikimit të dekretit ose vendimit. Afati është 30 ditë nëse dëbimi kryhet me shoqërim të menjëhershëm.

KU?

Ankimi duhet paraqitur tek gjykata e vëndit ku ka selinë autoriteti i cili ka vendosur dëbimin.

Kategoria e të huajve të cilët nuk mund të dëbohen:

Ligji parashikon që disa kategori të huajsh nuk mund të dëbohen dhe që duhet të pajisen me leje qëndrimi të përkohshme ose përfundimtare:

- Të huajt minore nën 18 vjeç.
- Të huajt në posedim të lejes së qëndrimit "CE" për banorët afatgjatë (mund të përjashtohen vetëm për arsye serioze të rendit publik dhe sigurisë kombëtare)
- Të huajt që jetojnë me të afërmit deri në shkallën e katërt ose me bashkëshortin me shtetësi italiane
- Gratë që janë shtatëzanë dhe ato deri në 6 muaj pas lindjes së fëmijës së tyre.

Ndalimi

Urdhërohet nga Kuestori për kohën ngushtesisht të nevojshme, ai kryhet **në qendrën e qëndrimit të përkohshëm** në rastin kur nuk është e mundur që dëbimi të ekzekutohet menjëherë. Vendimi i ndalimit duhet të konfirmohet nga gjykata brenda 48 orëve. Konfirmimi i ndalimit nga gjykata përfshin një qëndrim në qendrën e qëndrimit të përkohshëm për një total prej 180 ditësh.

2. Rezidenca, karta e identitetit, kodi fiskal, patentat, autoçertifikimi përkthimi dhe legalizimi i dokumentave

2.1. REGJISTRIMI NË GJËNDJEN CIVILE DHE REZIDENCA

SI?

Regjistrimi i një shtetasi të huaj me banim të ligjshëm kryhet në Zyrën e Gjendjes Civile të Komunës ku tregohen të dhënat personale, vendi i origjinës dhe adresa e vendbanimit të zakonshëm në Komunë. Duhet të tregohet leja origjinale e qëndrimit dhe pasaporta. Policia bashkiake do të bëjë kontroll në shtëpi për të konstatuar vendbanimin e tyre të zakonshëm.

Pasi të jetë bërë regjistrimi pranë gjëndjes civile, mund të kërkohen të gjitha dokumentat që mund të lëshojë **zyra e gjëndjes civile** (si psh: statusi familjar, vendbanimi etj). Është e mundur të lëshohet karta e identitetit (dokument i cili nuk është i vlefshëm për udhëtim jashtë shtetit për qytetarët jo komunitarë), duke patur akses në shërbimet sociale të ofruara nga Bashkia, si ndihma sociale, regjistrimi në çerdhe, etj. Regjistrimi është gjithashtu një parakusht për lëshimin ose konvertimin e patentës.

Regjistrimi në regjistrat e popullsisë rezidente duhet të rinovohet brenda 60 ditëve nga rinovimi i lejes së qëndrimit²¹. Nëse vendbanimi i zakonshëm transferohet në një shtëpi tjetër, ndryshimi duhet t'i komunikohet Zyres së Gjëndjes Civile ku qytetari është regjistruar. Anullimet nga regjistrat, si dhe regjistrimet dhe ndryshimet, komunikohen zyrtarisht nga Zyra e gjëndjes civile në Komisaratin e Policisë kompetente (Questura) brenda 15 ditëve.

2.2. KARTA E IDENTITETIT

PËR KË?

Karta e identitetit është dokumenti i cili vërteton identitetin e një subjekti dhe mund ti lëshohet të gjith shtetasve rezidentë në atë Bashki²².

.....

21 Pas gjashtë muajve nga skadimi i lejes së qëndrimit, nëse nuk bëhet kërkesë për rinovimin e regjistrimit të gjëndjes civile, ligji parashikon fshirjen e regjistrimit të gjëndjes civile të të huajit, përveç rastit të rinovimit të kësaj të fundit brenda 30 ditëve.

22 Për shtetasit jo komunitarë nuk vlen si dokument për udhëtim jashtë shtetit.

SI?

Vlefshmëri të përkohshme²³

- Tre vite për minorenët nga 0 deri 3 vjeç;
- 5 vite për minorenët nga 3 deri 15 vjeç;
- 10 vite për personat madhorë;

Dokumenti mund të rinovohet 180 ditë përpara afatit të skadencës. Lëshimi përpara këtij afati parashikohet vetëm në rast të shkatërrimit ose humbjes / vjedhjes (i provuar nga denoncimi përkatës). Ndryshimi i të dhënave në lidhje me statusin martesor, rezidencën ose profesionin nuk përbën një arsye për rinovim e kartës së identitetit.

KU?

Kërkohe në gjëndjen civile ku është bërë kërkesë për regjistrimin e gjëndjes civile.

Zyra e shërbimeve të gjëndjes civile (ufficio servizi demografici)

Zyra 1. Punë të përgjithshme dhe Personale

Adresa: Via Vintler, 16

Tel. 0471 99 71 11 (qendralini)

Fax: 0471 99 71 70

E-mail: 1.4.0@comune.bolzano.it

PEC (Posta elektronike e certifikuar) 1.4.0@pec.bolzano.bozena.it
demografici.comune.bz@legalmail.it

2.3. KARTA PROVINCIALE E SHËRBIMEVE (KARTA E SHËNDETIT - KODI FISKAL)

PËR KË?

Që nga viti 2011, karta e vjetër shëndetësore është zëvendësuar me Kartën e re të Shërbimit të Provincës, përmes së cilës mund të përdorësh shërbimet telematike të administratës publike.

Karta shëndetësore, përveç se është instrumenti për të përdorur shërbimet e Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (pa zëvendësuar librezën shëndetësore), ka të njëjtën vlefshmëri si karta e kodit fiskal. Karta shëndetësore gjithashtu garanton kujdesin shëndetësor në vendet e Bashkimit Evropian.

.....
23 Skadencia e dokumentave të lëshuara ose të rinovuara pas datës 9.2.2012, është e njëjtë me ditën e datëlindjaes së titullarit; psh. Një dokument i rinovuar/ lëshuar më datë 26 mars 2012 një personi madhor të lindur më datë 4 qershor, do të skadojë më datë 4 qershor 2022 (dhe jo më 26.3.2022).

SI?

Kodi Fiskal është i ndërtuar nga një seri gërmash dhe numrash të cilat shërbejnë për identifikimin një person për qëllimet fiskale, në dokumentat e punës dhe për të paguar taksat.

KU?

Në Bolzano, Karta Provinciale e Shërbimeve mund të kërkohet dhe aktivizohet pranë sporteleve të rrjetit civil:

**ZMP – Zyra për Marrëdhëniet me Publikun
(Bashkia e Bolzano-S)**

Vicolo Gumer 7 (kati përdhe në ndërtesën e bashkisë)

Orari: e hënë, e mërkurë, e premte: 8.30-12.30

e martë e enjte e qytetarit: 8.30-13.00 dhe 14.00-17.30

E-mail: urp@comune.bolzano.it

Tel. 0471 997 621

Osë pranë: Qendrave qytetare në lagje.

Qendra qytetare Centro-Piani-Rencio

vicolo Gumer 7 (kati përdhe në ndërtesën e bashkisë)

Tel. 0471 997 593

centro@comune.bolzano.it

Centro civico Oltrisarco-Aslago

piazza Angela Nikoletti 4, 1° piano

Tel. 0471 997 070

Fax 0471 997 074

oltrisarco@comune.bolzano.it

Qendra qytetare Europa-Novacella

via Dalmazia, 30/C

Tel. 0471 997 080

Fax 0471 997 084

europa@comune.bolzano.it

Qendra qytetare Don Bosco

piazza Don Bosco 17

Tel. 0471 997 050

Fax 0471 997 054

donbosco@comune.bolzano.it

Qendra qytetare Gries-S. Quirino

piazza Gries 18 (Antico Municipio di Gries)

Tel. 0471 997 060

Fax 0471 997 064

gries@comune.bolzano.it

Distriketi shoqëror-shëndetësor për lëshimin (shiko më poshtë seksionin 7.3) Në rastin e vjedhjes apo humbjes mund të kërkohet një dublikatë.

2.4. PATENTA (LEJA E DREJTIMIT TË MJETEVE)

PËR KË?

Pazenta është dëshmia e aftësisë për drejtimin e mjeteve motorrike dhe ciklo-motorrëve.

SI?

Përfitohet nëpërmjet një provimi që përfshin edhe një provë praktike të drejtimit.

KU?

Për informacion drejtohuni oranë çdo autoshkolle ose pranë zyrave të transportit rrugor (Ufficio Motorizzazione - Provincia autonoma di Bolzano).

Departamenti i Mobilitetit – provincia Autonome e Bolzano-S

Pallati 3b, Piazza Silvius Magnago 3

39100 Bolzano

Tel. +39 0471 41 46 90

Fax: +39 0471 41 46 99

<http://www.provincia.bz.it/turismo-mobilita/mobilita/>

Patenta ndërkombëtare kërkohet në vëndin e origjinës dhe e humbet vlefshmërinë me kalimin e një viti nga rezidenca në Itali.

2.5. DOKUMENTA TË IDENTIFIKIMIT

Në Itali, dokumentet (letërnjoftimi, pasaporta, leja e qëndrimit dhe patenta) duhet ti paraqiten me kërkesë të Policisë, Karabinierëve, Financës dhe Policisë Bashkiake. Nëse dokumentet janë kërkuar dhe ju jeni në pritje për lëshimin e tyre, atëherë duhet të ruani dhe mbani me vete vërtetimin e aplikimit.

2.6. AUTOCERTIFIKIMI

Disa certifikata mund të zëvendësohen nga një deklaratë e lëshuar nga personi i interesuar nën përgjegjësinë e tij mbi module të gatshme të vëna në dispozicion nga administrata.

2.7. PËRKTHIMI DHE LEGALIZIMI I DOKUMENTAVE

PËR KË?

Në rastin kur një dokument në gjuhë të huaj duhet të përkthehet dhe legalizohet për Administratën italiane.

KU?

- Duhet ti drejtoheni përfaqësive diplomatike italiane si (Ambasadës, Konsullatës) në shtetet e ndryshme të origjinës së shtetasit të huaj.
- Nëse dokumenti i cili duhet të përkthehet është tashmë në itali, duhet ti drejtoheni Gjykatës së Bolzano-s e cila disponon listën me përkthyesve zyrtar ose të mediatorëve ndërkultural të licencuar. Gjyqtari i paqes - (asseverazione).

Gjykata e Bolzano-s

Piazza Tribunale, 1 – 39100 Bolzano (BZ)

Tel. Centralini (+39) 0471 226111

3. Azili politik, refugjati politik dhe lejet e qëndrimit për arsye humanitare

3.1. AZILI POLITIK DHE REFUGJATËT POLITIK

Ndryshimet midis azilit politik; mbrojtjes me mbështetje dhe humanitare

- **Mbrojtja ndërkombëtare:**
 - azili/ statusi i refugjatit
 - mbrojtja me mbështetje (sussidio)
- **Mbrojtja humanitare**

AZILI POLITIK

Mbajtësit të **statusit të refugjatit** i lëshohet një leje qëndrimi për azil politik. Përfiton statusin e refugjatit ai i cili vërteton një frikë të bazuar për vuajtjen dhe persekutimin personal në vëndin e tij të origjinës sipas parashikimeve të Konventës së Gjenevës²⁴.

Për shembull, veprimet e persekutimit janë: dhuna fizike ose mendore, përfshirë dhunën seksuale; veprime e drejtuara kundër një gjinie ose kundër fëmijërisë; vendimet policore administrative apo gjyqësore të cilat janë diskriminuese ose joproporcionale; sanksionet penale si rezultat i refuzimit të kryerjes së shërbimit ushtarak në një konflikt kur kjo mund të sjellë kryerjen e krimeve të luftës ose krime kundër njerëzimit.

Nuk mjafton gjithsesi vetë fakti që një person ka pësuar apo ka rrezik të pësojë këto akte persekutimi, që të përfitojë azilin politik, por duhet që këto akte të jenë të lidhura me arsyet racore, të besimit të shtetësisë, të përkatësisë në një grup social, bindje politike.

Pas njohjes së statusit të refugjatit, komisariati i policisë duhet të lëshojë lejen përkatëse të qëndrimit për 5 vjet dhe të rinovueshme. Leja e qëndrimit i jep **të drejtë titullarit të saj për:**

- Kryerjen e punës si punëmarrës ose si i vetëpunësuar.
- Aksesin në punësim publik.
- Aksesin në shërbimin shëndetësor kombëtar.
- Aksesin në përfitimet e mirëqenies së INPS.
- Aksesin në studim.
- Dokumenti i udhëtimit: Shteti italian është i detyruar t'i sigurojë

.....

24 La Convenzione di Ginevra all'articolo 1 sancisce che è rifugiato "chi temendo a ragione di essere perseguitato per motivi di razza, religione, nazionalità, appartenenza ad un determinato gruppo sociale o per le sue opinioni politiche, si trova fuori del Paese di cui è cittadino e non può o non vuole, a causa di questo timore, avvalersi della protezione di questo Paese; oppure che, non avendo una cittadinanza e trovandosi fuori del Paese in cui aveva residenza abituale a seguito di siffatti avvenimenti, non può o non vuole tornarvi per il timore di cui sopra" – Lexo: neni 4 Ligji 121/2014!

refugjatit një dokument të barabartë me pasaportën.

- Bashkimi familjar: mbajtësi i azilit politik mund të kërkojë hyrjen e anëtarëve të familjes së tij në Itali, pa qenë nevoja të provojë kërkesat e strehimit dhe të të ardhurave të kërkuara për mbajtësit e llojeve të tjera të lejeve të qëndrimit.
- Shtetësinë italiane: koha e nevojshme për të aplikuar për shtetësi italiane me natyralizim është zvogëluar për gjysmën, pasi nevojiten 5 vjet qëndrimi në Itali në vend të 10.

MBROJTJA ME MBËSHTETJE

Mbrojtja me mbështetje lëshohet nga Komisioni Territorial kompetent nëse subjekti nuk provon të ketë pësuar një persekutim personal sipas nenit 1 të Konventës së Gjenevës të 1951, por megjithatë tregon rrezikun e vuajtjes së dëmtimit të rëndë nëse ai kthehet në vendin e tij të origjinës. Dëmi i rëndë do të konsiderohet: dënimi me vdekje ose ekzekutimi, tortura ose trajtime të tjera çnjerëzore, kërcënimi serioz dhe individual ndaj jetës që rezultojnë nga dhuna pa dallim në situatat e konfliktit të armatosur të brendshëm ose ndërkombëtar. Leja relative e qëndrimit me kohëzgjatje prej 5 vitesh lëshohet nga Komisariati i Policisë dhe mund të rinovohet me verifikimin e ekzistencës së shkaqeve që lejuan lëshimin e saj. Leja i jep të drejtë atyre që e mbajnë atë:

- Kryerja e aktiviteteve të pavarura si i vetëpunësuar ose të të punës si punëmarrës.
- Aksesin në punësim publik.
- Aksesin në shërbimin shëndetësor kombëtar.
- Aksesin në përfitimet e mirëqenies së INPS.
- Aksesin në studim.
- Dokument udhëtimi: komisarati i policisë duhet të lëshojë një dokument udhëtimi të vlefshëm vetëm nëse mbajtësi i mbrojtjes me mbështetje ka arsye të vlefshme që nuk i lejojnë atij të kërkojë pasaportë nga autoriteti diplomatik i vendit të origjinës. Ndonjëherë, por ky nuk është gjithmonë rasti, varet nga komisarati i policisë: në rast abuzimi ose raportimi është gjithmonë e nevojshme t'i drejtohem shoqatave që mbrojnë të drejtat e refugjatëve.
- Bashkimi familjar: edhe në këtë rast mbajtësi i mbrojtjes me ndihmë mund të kërkojë hyrjen në Itali të anëtarëve të familjes së tij pa pasur nevojë të demonstrojë kushtet e strehimit dhe të të ardhurave të kërkuara për mbajtësit e llojeve të tjera të lejeve të qëndrimit.
- Është e mundur të konvertohet leja e qëndrimit për mbrojtje me ndihmë, në një leje qëndrimi për arsye pune, duke hequr dorë nga statusi i mbrojtjes plotësuese.

MBROJTJA UMANITARE

Leja e qëndrimit për arsye humanitare lëshohet kur nuk ekzistojnë kërkesat për azil politik dhe as për mbrojtje me mbështetje. Ju keni të drejtë për këtë lloj leje kur ka arsye serioze, në veçanti të një natyre humanitare ose që rrjedh nga detyrimet kushtetuese të Shtetit Italian. Leja lëshohet nga Komisariati i Policisë me kërkesë të Komisionit Territorial që ka shqyrtuar gjendjen e kërkesit ose me kërkesë të shtetasit të huaj.

Masat kryesore të D.L. 113/2018 (c.d. decreto Salvini) Siguria dhe migracioni në lidhje me politikat migratore:

- **Abrogim i lejes së qëndrimit për arsye humanitare dhe disiplinim i rasteve speciale për lëshimin e lejes së qëndrimit të përkohshme për nevoja të karakterit umanitar:**
 - akte me vlerë të një rëndësie të lartë civile,
 - shfrytëzim i rëndë në punë,
 - dhuna shtëpiake,
 - fatkeqësi natyrore të jashtëzakonshme,
 - arsye shëndetësore të një rëndësie të jashtëzakonshme,
- **Zgjatja e afatit maksimal të ndalimit në qëndrën e qëndrimit për riatdhesim (CPR) (180 ditë), afati është në përputhje me kohën maksimale të parashikuar nga direktiva europiane mbi riatdhesimin 2008/115/BE.**

Mbajtja e azilkërkesve në qendrat Hot Spot, për një periudhë maksimale që nuk i kalon 30 ditë, me qëllim që të konstatohet identiteti ose shtetësia e tyre. Aty ku nuk ka qenë e mundur të përcaktohet identiteti i tyre, mund të kryhet ndalimi në qendrat e ndalimit për riatdhesim deri në një **maksimum prej 180 ditësh.**
- Mundësia e ndalimit të të huajve që do të dëbohen edhe në struktura të tjera të përshtatshme, në dispozicion të sigurisë publike në rastin e pamundësisë së qëndrave të qëndrimit për riatdhesim (CPR).
- Vlefshmëria e ndalimit të ri-hyrjes së të huajit të dëbuar jo vetëm në Itali por në gjithë zonën Schengen. – Ndërprerja e aktit që kishte krijuar tridhjetë sportele bashkiake për riatdhesimin vullnetar dhe transferimin e risorsave monetare tek fondi i riatdhesimit të Ministrisë së Brendshme.
- Zgjerimi i fushës së krimeve të cillat sjellin mos aprovimin ose revokimin e mbrojtjes ndërkombëtare, ku përfshihen ato të krimeve me rëndësi shoqërore sikur janë krimet seksuale ose krimet e lidhura me substancat narkotike.
- Përfundimi i mbrojtjes ndërkombëtare për shkak të rihyrjes së titullarit të së drejtës në vëndin e tij të origjinës.
- Urdhra për të ndaluar ankimin procedural ndaj kërkesave të

përsëritura për mbrojtjen ndërkombëtare.

- Mundësia për Komisionin territorial për të pezulluar kërkesën kur ndaj kërkesit zhvillohet një procedim penal për një nga krimet për të cilat në rast dënimi përfundimtar do të sillte mospranimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe janë prezent dyshimet për rrezikshmëri. Në këtë rast kërkuesi ka detyrimin e largimit nga territori kombëtar. Brënda 12 muajve nga vendimi i pafajësisë, i interesuari mund të kërkojë rishqyrtimin e kërkesës dhe rihapjen e hetimit për procedimit për mbrojtje ndërkombëtare. Me kalimin e kësaj periudhe kohore pa kryer kërkesë për rihapje të hetimit, Komisioni kompetent deklaron shuarjen e procedimit.
- **Rezerva e mikpritjes në sistemin ex-WSPRAR vetëm për titullarët e mbrojtjes ndërkombëtare dhe për minorenët e huaj të pa shoqëruar.**
- **Përgjashtimi i përkohshëm për shkak të egzigjencave me karakter umanitar, si titull i vlefshëm për regjistrimin** në gjëndjen civile nuk përjashton aksesin në shërbimet e njohura nga legjislacioni aktual për azilkërkuetit, sikur janë (regjistrimi në shërbimin shëndetësor, aksesin për punë, regjistrimi në shkollë i fëmijëve, masat për mikpritjen) të cilat bazohen tek titulli i lejes së qëndrimit.
- **Heqja e shtetësisë** për krimet e terrorizmit të vërtetuara me vendim përfundimtar brënda 3 viteve nga marrja formës të prerë e vendimit të dënimit për krimet e mësipërme.

KU?

Commissariato del Governo per la provincia di Bolzano

Vle Principe Eugenio di Savoia, 11, 39100 Bolzano

Centralino 0471 294611

PE.C.: protocollo.comgovbz@pec.interno.it

<http://www.prefettura.it/bolzano/multidip/index.html>

4. Shtetësia

4.1. ATRIBUIM AUTOMATIK

SI?

Shtetësia fitohet:

- **Për shkak të lindjes** nga prind Italian;
- **Me kalim të së drejtës**, i huaji që bëhet shtetas italian me natyralizim transmeton automatikisht shtetësinë italiane fëmijëve të tij të mitur, të cilët kur arrijnë moshën madhore mund ta heqin dorë nga ajo nëse kanë shtetësi tjetër.

4.2. SHTETËSIA PËR SHKAK TË PËRFITIMIT NGA LIGJI

I huaji, prindi i cilit ose një nga paraardhësit në vijën e drejtë të shkallës së dytë (gjyshërit) është/janë shtetas italianë, mund të fitojnë shtetësinë italiane me deklaratë eksplicite:

- Nëse kryen shërbimin ushtarak për shtetin
- Nëse kryen punë publike për shtetin
- Nëse, me arritjen e moshës madhore, ai ka banuar ligjërisht në Itali për të paktën dy vjet.

I huaji i cili ka lindur në Itali, mund të bëhet shtetas italian nëse qëndron ligjërisht në territorin italian pa ndërprerje derisa të arrijë moshën madhore dhe shpreh dëshirën për të fituar shtetësinë brenda një viti nga mbushja e moshës 18 vjeç ose më qartë para se të mbushë 19 vjeç.

4.3. NATYRALIZIMI

Natyralizimi është mënyra e fitimit të shtetësisë nëpërmjet nxjerrjes së një vendimi administrativ i cili mund të përfitohet nëpërmjet:

Me martesë me shtetas Italian:

SI?

Ku ke të paktën 24 muaj rezidencë të ligjshme në Itali pas martesës ose pas kalimit të tre viteve nga martesa.

KU?

Prefekturë (për Provincën e Bolzano-s: **Commissariato del governo**)
(autoriteti konsullor italian jashtë shtetit, nëse banoni jashtë shtetit)

Ministria e brëndëshme: duhet të nxjerri brënda 4 viteve nga kërkesa, në

rast të kundërt, kërkuesi fiton një të drejtë subjektive dhe mund të fitojë tëk gjykatësi i paqës një vendim për deklarimin e shtetësisë.

Për natyralizim të zakonshëm, e cila i jepet shtetasit jo komunitar në rastin kur:

- Jeton rregullisht dhe vazhdimisht në Itali për të paktën dhjetë vjet dhe ka një vendbanim efektiv dhe të përhershëm
 - Ka qenë gjithmonë në përputhje me rregullat e qëndrimit
- Kërkesa për fitimin e shtetësisë me natyralizim duhet t'i paraqitet Prefekturës (Commisariato del Governo).

Lista e dokumenteve që do t'i paraqiten Prefekturës për natyralizim të zakonshëm:

a. Dokumentat të cilat merren në vëndin e origjinës²⁵:

1. Ekstrakt nga akti i lindjes i plotë i cili duhet të përmbajë atësinë dhe amësinë i përkthyer dhe legalizuar nga autoriteti diplomatik ose konsullor italian.
2. Çertifikatë penale nga shteti i origjinës e përkthyer dhe e legalizuar.

b. Dokumenta të cilat mund të bëhen në Itali osë dhe të vetdeklarohen (deklarim me përgjegjësi vetjake) me kërkesë:

1. qëndrimi historik në 10 vitet e fundit në Itali: tregoni ku keni qenë banor (qytet, adresë)
2. statusi familjar: sa njerëz janë në familje në Itali
3. gjendja penale: certifikata e përgjithshme e të dhënave penale (Gjykata)
4. deklaratat tatimore për 3 vitet e fundit
5. deklarata me të cilën autorizohen autoritetet e vendit tuaj për të dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm tek autoritetet italiane.

KU?

Commissariato del Governo per la provincia di Bolzano

Vle Principe Eugenio di Savoia, 11, 39100 Bolzano

Centralino 0471 294611

PE.C.: protocollo.comgovbz@pec.interno.it

<http://www.prefettura.it/bolzano/multidip/index.html>

.....

25 SHËNIM: Duhet të konfirmoni që shteti i origjinës pranon dyshtetësinë, përndryshe do të duhet të hiqet dorë nga shtetësia e shtetit të origjinës përpara fitimit të asaj italiane.

5. Punësimi

5.1. PUNËSIMI PËR SHETASIT E HUAJ TË CILËT ZOTËROJNË NJË LEJE QËNDRIMI

Shtetasit e shteteve jo komunitare kanë nevojë për një leje pune për të punuar në Itali.

Shtetasit e shteteve komunitare, përfshirë ato të Rumanisë dhe Bullgarisë, kanë akses të lirë në tregun e punës italian dhe nuk nevojitet leje pune.

5.2. PUNA PËR KË VJEN NGA JASHTË SHETIT

Parakushti për dhënien e autorizimeve për punë në Itali është publikimi i dekretit vjetor të fluksit të emigrantëve, i cili përcakton kuotat maksimale të hyrjes për arsye pune.

Kujdes, **Dekreti mbi Flukset nuk publikohet me rregullsi vjetore!**

Puna si i punësaur: autorizmi KUSH?

Punëdhënësi, italian ose i huaj i cili jeton rregullisht në Itali.

NË FAVOR TË KUJT?

Për të huajin rezident jashtë shtetit i cili dëshiron të ndërmarrë një punë si punëmarrës në Itali.

SI?

Nga viti 2010 **kërkesat për autorizim për punë mund të kërkojnë ekskluzivisht nëpërmjet faqes web** në adresën e Ministrisë së Brëndshme www.interno.it.²⁶ Formularët mund të plotësohen edhe para se të publikohet **Dekreti mbi Flukset**, por transmetimi i tyre lejohet vetëm pasi dekreti të ketë hyrë në fuqi. Brënda 8 ditëve nga hyrja në Itali, punonjësi duhet të **firmosi kontratën e qëndrimit pranë Zyrës së Shërbimit për Punë dhe të kërkojë lëshimin e Lejes së Qëndrimit** nëpërmjet postës tek **Kuestura kompetente**. Vetëm në këtë pikë mund të fillojë marrëdhënia e punës.

Shtetasve të huaj u lejohet të hyjnë në territorin italian për arsye të punës si punëmarrës (sezonal ose të përhershme), për kërkim të punës ose për vetëpunësim. Shtetasi i huaj mund të ndryshojë më pas llojin e

.....

26 Kërkesat në letër nuk janë më të pranueshme dhe nuk përpunohen.

punës, nga puna si punëmarrës në vetëpunësim dhe anasjelltas, pa pasur nevojë të informojë Kuesturën. Konvertimi duhet të komunikohet kur të rinovohet leja e qëndrimit. Është gjithashtu e mundur që leja për arsye turistike të konvertohet në një leje për vetëpunësim, kur plotësohen kushtet.

KU?

Kërkesat e trasmetuara në mënyrë telematike merren nga Ministria e Bredshme e cila ja kalon kërkesën Provincave kompetente. Të gjitha kërkesat përpunohen në mënyrë të njëhershme nga Provinca dhe Kuestura. Zyra e shërbimit të punës më pas i lëshon punëdhënësit lejen. Pasi të jepen mendimet pozitive, kërkesa sëbashku me propozimin për lidhjen e kontratës së qëndrimit i dërgohen ambasadave apo konsullatave Italiane në shtetet e origjinës për ti lejuar shtetasit të huaj hyrjen në Itali me vizën përkatëse për arsye pune.

KUSH MUND TË NDIHMOJË?

Patronatet, shiko më poshtë!

PËR KË?

Për punëmarrësit me probleme pushimi nga puna, masat disiplinore, diferenca në pagesë, “mobbing”, diskriminim, etj.

KUSH MUND TË NDIHMOJË?

Patronatet, shiko më poshtë!

Puna si punëmarrës: asistenca për mbështetjen sociale

PËR KË?

Për punëmarrësit me probleme që lidhen me sëmundje, dëmtim në punë, mëmësinë, mobilitetin, invaliditetin, pensionin, pagesën për papunësi, etj.

KUSH MUND TË NDIHMOJË?

Patronatet, shiko listën <http://www.provincia.bz.it/asse/indirizzi-patronati.asp>

CAAF ACLI

Via Sassari, 4/BC, 39100 Bolzano (BZ)

Tel. 0471 30 16 89

E-mail: bolzano@acliservice.acli.it

CAAF ACLI

Via Alto Adige 28, 39100 Bolzano (BZ)

Tel. 0471 30 16 89

E-mail: bolzano@acliservice.acli.it

CAAF ASGB

Via Bottai 22, 39100 Bolzano

Tel. 0471 30 82 10

E-mail: patronat@asgb.org

CAAF CGIL/AGB

Via Piacenza 54, 39100 Bolzano

Tel. 0471 92 64 02 / Tel. 0471 92 64 08

E-mail: m.gjoni@servizi-cgil.it

CAAF CGIL/AGB

Viale Trieste 78, 39100 Bolzano

Tel. 0471 / 19 56 111

E-mail: g.chiarella@servizi-cgil.it

CAAF CGIL/AGB

Piazza Don Bosco 1/A, 39100 Bolzano

Tel. 0471 19 56 111 / +39 340 5397642

E-mail: a.lucchiari@servizi-cgil.it

CAAF CGIL/AGB

Via Claudia Augusta 55/B, 39100 Bolzano

Tel. 0471 / 27 00 15

E-mail: a.gencarelli@servizi-cgil.it

CAAF SGBCISL

Via Milano 121/A, 39100 Bolzano

Tel. 0471 / 20 46 02

E-mail: info.service@sgbcisl.it

CAAF SGBCISL

Via Siemens 23, 39100 Bolzano

Tel. 0471 56 84 25 / 0471 56 84 10

E-mail: info.service@sgbcisl.it

CAAF CNA/SHV

Via Righi 9/2, 39100 Bolzano

Tel. 0471 54 67 77

E-mail: info@shv.cnabz.com

CAAF CNA/SHV

Via Milano 68, 39100 Bolzano

Tel. 0471 54 67 51

E-mail: bolzano@epasa-itaco.it

CAAF Coldiretti

Via Buoizzi 16 - 2° piano, 39100 Bolzano

Tel. 0471 92 19 49

E-mail: marika.luciano@coldiretti.it

CAAF Commercianti

Via Roma 80/A, 39100 Bolzano

Tel. 0471 54 15 00

E-mail: info@commercianti.bz.it

CAAF FABI

Via Conciapelli 24, 39100 Bolzano

Tel. 0471 97 18 25

E-mail: caaf.bz@fabibz.it

CAAF HDS

Via di Mezzo ai Piani 5, 39100 Bolzano

Tel. 0471 97 80 32

E-mail: mriegler@hds-bz.it

CAAF KVĚ

Via Delai 10, 39100 Bolzano

Tel. 0471 32 35 96

E-mail: service.bozen@kvě.org

CAAF LVH

Via di Mezzo ai Piani 7, 39100 Bolzano

Tel. 0471 32 32 00

E-mail: bozen@lvh.it

CAAF Bauernbund

Via Canonico Michael Gamper 10, 39100 Bolzano

Tel. 0471 99 94 49

E-mail: enapa.bozen@sbb.it

CAAF UGL

Vicolo S. Quirino 2, 39100 Bolzano

Tel. 0471 27 17 06

E-mail: enas.altoadige@libero.it

CAAF UIL/SGK

Via Ada Buffulini 4, 39100 Bolzano

Tel. 0471 24 56 60

E-mail: gigi.mongelli@uilsgk.it

5.3. PUNA AUTONOME

Puna autonome dhe kooperative

PËR KË?

Edhe për të huajt me qëndrim të ligjshëm ekziston mundësia për të kryer punë të pavarur në Itali. Sidoqoftë, përjashtohen aktivitetet që ligji rezervon në mënyrë eksplicite për qytetarët italianë. Ekziston edhe mundësia e krijimit të shoqërive aksionare ose të njerëzve, aksesit në detyrat e shoqërive (si administrator, drejtor, etj.) dhe krijimit të kooperativave. Duke pasur parasysh gjerësinë e mundësive dhe problematikave, është e nevojshme të kontaktoni shoqatat e kategorisë për informacione dhe detaje të mëtejshme.

Për të kryer punë si i vetëpunësuar:

- Në shumicën e rasteve, ju duhet të regjistroheni me një kategori profesionale ose regjistër;
- Për disa aktivitete ka kërkesa specifike profesionale dhe në disa raste kualifikime me provim;
- Për të kryer disa aktivitete nevojiten autorizime të ndryshme sikur mund të jenë ato të (A.S.L., Bashkisë, etj.);
- Për të gjitha aktivitetet e vetëpunësimit është e nevojshme të hapet numri NUI-s (Numri unik i Identifikimit – PIVA);
- Regjistrimi në kategoritë profesionale dhe në regjistrat e profesionistëve si dhe hapja e numri NUI-s (Numri unik i Identifikimit) kanë një kosto. Taksat paguhen në përpjesëtim me të ardhurat, kontributet e INPS-it dhe për disa aktivitete, kontributet e INAIL-it duhet t'i paguhen drejtpërdrejtë organeve përkatëse.
- Është e këshillueshme që të konsultohet me një kontabilist të besuar.
- Për njohjen e kualifikimeve profesionale: <https://civis.bz.it/it/servizi/servizio.html?id=1006140>

KUSH MUND TË NDIHMOJË?

- APA, CNA, Confesercenti, Lega delle Cooperative – Confcooperative – Coperdolomiti etj,...

5.4. MBËSHTETJA SHOQËRORE: NDIHMA FAMILJARE, PENSIONI, RIMARRJA E KONTRIBUTEVE NË RAST KTHIMI NË ATDHE

Ndihma familjare

PËR KË?

Ndihma për familjen i takon çdo punonjësi italian apo të huaj, të cilët janë të regjistruar tek ndihma sociale, kur të ardhurat e përgjithshme të familjes nuk kalojnë limitet e përcaktuara nga ligji.

SI?

I interesuari duhet të paraqesi kërkesë duke plotësuar një modul të cilin e gjen tek INPS-i.

KU?

Kërkesa për ndihmë familjare duhet ti paraqitet: punëdhënësit, në rastin kur kërkuesi është punëmarrës, jo bujqësor, me përjashtim të personave të cilët punojnë në shërbimet në shtëpi dhe familje; tek INPS-i në të gjitha rastet e tjera.

INPS

Adresa: Piazza Domenicani, 30, 39100 Bolzano BZ

Orari: Të mërkurën ora 08:15

Provincia: Provincia autonoma di Bolzano

Telefon: 0471 996611

https://servizi2.inps.it/servizi/StrutturesulTerritorioInternet/wform2_nojava.aspx?parm=1&lf20=S0&parm3=140000&gf20=

Pensionet

PËR KË?

Punëmarrësit, punonjësit në bujqësi, artizanët, tregtarët, sipërmarrësit bujqësor, ndihmësit në familje dhe ato që punojnë në vendqendrim, janë **detyrimisht** të siguruar tek INPS-i kundër rreziqeve të invaliditetit, pleqërisë dhe pasardhësve.

SI?

Kategoritë e pensinit të INPS-it janë pesioni i pleqërisë, pensioni i pamundësisë, ndihma e zakonshme e pamundësisë, ndihma e zakonshme e invaliditetit dhe pensioni për të mbijetuarit.

KU?

Për të marrë pensionin është e nevojshme paraqitja e kërkesës pranë INPS-it, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet patronatit i cili ndihmon falas punonjësin.

Marrja e kontributeve në rast të kthimit në atdhe PËR KË?

Punonjësit e huaj të cilët përfundojnë aktivitetin e punës në Itali dhe lejnë territorin kombëtar kanë te drejtë të kërkojnë likuidimin e kontributeve të cilat rezultojnë të derdhura në favor të tyre tek INPS-i, me një shtesë prej 5% në vit. Përveç rasteve kur fusha në fjalë nuk është e rregulluar me marrëveshje ndërkombëtare.

SI?

- Paraqitja e një kërkesë specifike në INPS;
- Kthimi i lejes së qëndrimit në kufi (mbajtja e një fotokopje në të cilën zyra e kufirit do të vërtetojë se origjinali është kthyer);
- Zyra kufitare kthen lejen e qëndrimit në Kuesturë, e cila informon INPS-in për kthimin;
- INPS-i siguron që të paguajë shumat e duhura për t'u kthyer tek punëtori duke i depozituar ato në një llogari rrjedhëse në një institucion bankar në vendin e punonjësit.

KU?

Istituti Kombëtar i Mbrojtjes Sociale (INPS)

KUSH MUND TË NDIHMOJË?

Patronatet (shiko 5.2)

6. Asistenca shëndetsore

6.1. REGJISTRIMI NË SHËRBIMIN SHËNDETSOR KOMBËTAR

PËR KË?

Regjistrimi në Shërbimin Shëndetsor Kombëtar (S.S.N.) pranë Qendrës Shëndetësore Lokale (A.S.L.) të rezidencës, ose në mungesë, të qëndrimit të zakonshëm, për vete dhe për familjarët në ngarkim **është e detyrueshme për shtetasit e huaj**:

- **Të cilët zotërojnë lejeqëndrimin** për punësim si punëmarrës ose si i vetpunësuar ose për arsye pune, për azil politik ose humanitar, ose për ata të cilët kanë bërë kërkesë për azil ose në pritje të birësimit, për rritje dhe edukim ose për marrje shtetësie.
- **Personat e regjistruar në zyrat e punësimit**, ku përfshihet dhe ndihma rehabilituese ose sidoqoftë të cilët kryejnë një punë, pavarësisht faktit që arsyeja e qëndrimit e vendosur në lejen e qëndrimit nuk parashikon regjistrimin e detyrueshëm tek S.S.N.

Shënim: Ajo përfshin vetëm asistencën shëndetsore të dhënë në Itali. Kurat e dhena jashtë shtetit janë në ngarkim të pacientit të huaj.

Regjistrimi tek A.S.L. është i vlefshëm për të gjith kohën e vlefshmërisë së lejes së qëndrimit; për regjistrimin **në mungesë të rezidencës** (regjistrimi në gjendjen civile), vendi i qëndrimit është ai i shënuar në lejen e qëndrimit. Për punonjësit stinorë, regjistrimi bëhet tek a A.S.L. të bashkisë së shënuar/treguar për lëshimin e lejes së qëndrimit.

Për titullarët e lejes së qëndrimit për kërkesë për azil shërbimet jepen të asimiluara më ato të të papunëve të regjistruar tek listat e punësimit, duke i përjashtuar nga sistemi i bashkëpjessmarrjes në shpenzim (ticket).

KUSH KA TË DREJTË TË PËRFITOJË NGA NDIHMA SHËNDETSORE?

Kanë të drejtë:

- **Të huajt në pritje të rinovimit të lejes së qëndrimit** për arsye pune si punëmarrës ose si i vetpunësuar, për arsye familjare, azil, në pritje të birësimit, të lënies për rritje dhe edukim ose fitimit të shtetësisë, me paraqitjen e lejes së qëndrimit ose të dokumentacionit që provon kërkesën për rinovim.
- **Miniorenët në pritje të regjistrimit** (që nga lindja) dhe fëmijët e të huajve të regjistruar në Shërbimin Shëndetsor Kombëtar.
- **Familjarët e rregullt** në ngarkim të të huajt

KUR PËRFUNDON REGJISTRIMI NË SHËRBIMIN SHËNDETSOR KOMBËTAR (S.S.N.)?

Regjistrimi tek S.S.N. përfundon në momentin e komunikimit nga ana e Kuesturës tek A.S.L.-i të:

mungesës së rinovimit të lejes së qëndrimit
revokimit apo anulimit të lejes së qëndrimit
ekspulsit²⁷

KUSH NUK KA DETYRIMIN PËR REGJISTRIM?

Titullarët e lejes së qëndrimit për biznes nuk kanë detyrimin e regjistrimit, ndërsa një kategori e punonjësve të huaj dhe familjarët e tyre nuk kanë detyrimin për regjistrim tek S.S.N., por duhet të kryejnë sigurimin shëndetësor për rrezikun e sëmundjes, të aksidentit në punë dhe të lejes së lindjes.

Këta janë:

- **Drejtuesit dhe personili i huaj i specializuar të shoqërive të cilat kanë selinë në Itali**, - të zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja të cilat kanë selinë qëndrore në territorin e një shteti anëtar të Organizatës Botërore të Tregtisë, - të selive kryesore në Itali të shoqërive italiane ose të shoqërive të një shteti tjetër të Bashkimit Europian.
- **Punëmarrësit apo punëdhënësit rezident jashtë shtetit**, të transferuar përkohësisht, pranë personave fizik ose juridik në Itali për shërbime të paracaktuara.
- **Gazetarë të akredituar në Itali** ose të punësuar tek organet e gazetarisë, të përditshmeve ose periodikëve, ose të trasmetuesve radiofonik apo televiziv të huaj.

Shtetasit e huaj të cilët qëndrojnë ligjrisht në Itali dhe që nuk janë të regjistruar tek S.S.N.-sa duhet të paguajnë shërbimin shëndetësor, qoftë urgjente apo jo, sipas tarifave të përcaktuara nga Krahinat apo Provincat Autonome.

Regjistrimi vullnetar tek shërbimi shëndetësor kombëtar PËR KË?

Është i mundur regjistrimi vullnetar tek S.S.N - ja për të huajt

- **me një leje qëndrimi të vlefshme për më shumë se tre muaj** për arsye të ndryshme nga punësimi ose vetëpunësimi, regjistrimi në listat e punësimit, arsyet familjare, azil, në pritje të adoptimit, pritjen e kujdestarisë ose pritjen për fitimin e shtetësisë, ata paguajnë një kontribut vjetor të vlefshëm për vete dhe për familjarët në ngarkim.

27 Përveç rastit kur shtetasi i huaj nuk arrin të tregojë ekzistencën e një ankimi kundër vendimeve të mësipërme.

Ky kontribut llogaritet si përqindje e të ardhurave të fituara në vitin paraardhës (në Itali ose jashtë), siç parashikohet për qytetarët italianë.

- të cilët janë në zotërim të **lejes së qëndrimit për arsye studimi ose të barazvlefshëm, me pagesën e një kontributi vjetor forfe** i cili nuk është i vlefshëm për familjarët në ngarkim.

Shetasve të huaj të cilët nuk kanë një leje qëndrimi të rregullt, pa të ardhura ekonomike të mjaftueshme janë të garantuara falas:

- kurimi ambulator dhe spitalor urgjent, për sëmundje dhe aksidente dhe akses në programet e mjekësisë parandaluese
- mbrojtja sociale e shtatëzanisë dhe e amësisë dhe atësisë dhe trajtim i barabartë me gratë italiane.
- mbrojtja e shëndetit të të miturit
- vaksinimi, ndërhyrjet profilaktike ndërkombëtare dhe kurimi i sëmundjeve infektive.

Gjendja e pamundësisë/nevojës mund të dokumentohet nëpërmjet një vetdeklarimi nga ana e të interesuarit tek struktura shëndetsore ku ky i fundit drejtohet.

Për dhënien e shërbimit ndaj shtetasve të huaj jo të rregullt, përdoret një kod regjional identifikimi i vlefshëm në të gjithë territorin kombëtar, i përbërë nga sigla S.T.P. (Straniero Temporaneamente Presente) e cila është e vlefshme për përshkrimin e recetave për ilaçe që jepen nga farmacitë me kontratë me shërbimin shëndetsor, me trajtim të barabartë në shpenzim me shtetasit Italian në nevojë.

Mjeku i familjes

PËR KE?

Kush është i regjistruar tek Shërbimi Shëndetsor Kombëtar (librezën shëndetsore në letër) ka të drejtë të zgjedhi një mjek familje. Duhet ti drejtoheni këtij mjeku për vizitat ambulatorie të përgjithshme. Ose për dhënien e ilaçeve, për të kërkuar vizita të specializuara, për të marrë certifikata të sëmnudjes (mungesë nga puna), për vizita në shtëpi kur i sëmuri nuk mund të shkojë vet tek mjeku, ose për shërbime të tjera jo të specializuara.

KU?

Zgjedhja e mjekut të familjes kryhet në momentin e regjistrimit pranë sporteleve të A.S.L.

<http://www.asdaa.it/it/default.asp>

6.2. AMËSIA DHE FEMIJËRIA

PËR KË?

Për gruan shtatzënë janë të garantuara falas të gjitha ekzaminimet mjekësore të vlerësuara si të rëndësishme, ajo, edhe pa leje qëndrimi përgjatë kohës së shtatzënisë nuk mund të dëbohet dhe ka të drejtë për të gjithë asistencën e nevojshme.

KU?

Këshillitorja e familjes është vendi më i përshtatshëm dhe i sigurt për të ndihmuar gruan shtatzënë dhe për të ndjekur më pas zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve.

SI?

Në muajt e parë të shtatzënisë është shumë e rëndësishme bërja e disa analizave për shëndetin e fëmijës dhe të nënës: bëhet fjalë përgjithësisht për disa analiza mjekësore falas.

Vaksinimet e detyrueshme

PËR KË?

Për fëmijët që ndodhen në territorin Italian janë të detyrueshme këto vaksina:

Vaksinimet në moshën fëmijore

Vaksinimet në moshën fëmijore fillojnë pas muajit të 2^o të jetës me vaksinën e kombinuar ekzavalente (për prodhimin e mbrojtësve kundër poliomelitit, difteritit, tetanozit, epatitit B, pertozës, haemophilus influenzae ose Hib). Kjo vaksinë më pas jepet në 2 doza të tjera, njëra në muajin e 5^o dhe tjetra në muajin e 11-12^o.

Përgjatë muajit të 12^o-15^o, bëhet vakcina e kombinuar kundër fruthit, rubeolës, shytave dhe lisë.²⁸

Në moshën e fillimit të shkollës (6^o vite jetë) bëhet vakcina antipolenë, sëbashku me atë kundër difteritit, tetanozit dhe pertusis. Në të njëjtën kohë ftohen për kryerjen e vaksinimit të dytë të fruthit, rubeolës, parotitit dhe verticelës.

Fëmijët të cilët i përkasin kategorive në rrezik – më përshkrim nga pediatri – mund të vaksinohen kundër hepatitit A ose kundër virusit i cili provokon encefalitin i cili mund të merret nga morrat (TBE).

.....
28 Më shumë informacion gjeni në: www.deciditi.info

Për informacion të mëtejshëm: lexoni “Vaksinimi mbron Sepse më pëlqen jeta” www.iflow.it/vaccinare

KU?

Zakonisht duke u paraqitur në ambulator në oraret e përcaktuara.
<http://www.asdaa.it/it/default.asp>

6.3. PARANDALIMI I SHTATËZANISË NËPËRMJET KONTRACEPTIVËVE

Parandalimi (Kontraceptimi) është tërësia e mënyrave për të shmangur shtatëzaninë e pa dëshiruar.

KU?

Mënyra më e mirë për të marrë informacion të plotë mbi parandalimin e shtatëzanisë së pa dëshiruar është duke ju drejtuar **Konsultoreve Familjare**.

Consultorio Familiare Mesocops

Via dei Portici, 22 · 0471 976664

Consultorio Familiare P. M. Kolbe

Vicolo Mendola, 19 · 0471 401959

Consultorio Familiare AIED Sezione Andreina Emeri

Corso Italia, 13 · 0471 979399

6.4. NDËRPRERJA E SHTATËZANISË

PËR KË?

Gruaja e cila dëshiron të ndërpresë shtatëzaninë është e mbrojtur nga ligji; Aborti është i mundur në këto raste:

- nëse bëhet në spitalin publik;
- vetëm përgjatë 12 javëve të para të shtatëzanisë;

KU?

Gruaja e cila vendos të abortojë mund ti drejtohet **Konsultores Familjare**, spitalit ose ti kërkojë këshillë mjekut të saj.

SI?

Për ndërprerjen e shtatëzanisë është e nevojshme një rekomandim nga mjeku; më mirë nëse bëhet tek Konsultorja Familjare.

Për minoret nën 18 vjeç, Konsultorja do të kërkojë lejen ligjore.

6.5. KONSULTORËT FAMILJARE

Pranë ç'do Qendër Shëndetësore Lokale (A.S.L.) janë në funksion Konsultorët Familjare të cilët kanë për detyrë të japin asistencë gratis për gratë me barrë, edhe nëse nuk kanë leje qëndrimi, ndihma jepet gjithashtu për fëmijët e saj nën moshën 18 vjeç.

Pranë Konsultorit ofrohen shërbime të ndryshme në mënyrë individuale, në kopje ose në grup në lidhje me:

- asistencë shëndetësore për nënën shtatëzënë (asistencë obstetrike-gjinekologjike, kurse që përgatisin për lindjen dhe rritjen e fëmijës, etj.);
- asistencë grave që vendosin ndërprerjen e barrës me abortim në bazë të ligjit nr. 194/78;
- asistencë gjinekologjike për patologji të ndryshme lidhur me sëmundjet e seksualitetit, sterilitetit dhe infertilitetit; konsulencë për metodat kontraceptive;
- kontrolle dhe diagnoza për sëmundje tumorale të aparatit gjenital të femrës;
- konsulencë lidhur me probleme psikologjike dhe sociale në lidhje me raportin në çift, raportin prind-fëmijë, shtatzanisë, lindjen dhe seksualitetin;
- ndërmjetësim familjar;
- asistencë për raste divorci, keqtrajtimi dhe dhune shtëpiake;
- informacione mbi adoptimin dhe lënien për rritje dhe edukim (kujdestarinë);
- asistencë shëndetësore për fëmijët të cilët nuk janë të regjistruar në Shërbimin Shëndetësor;
- vaksinime kundër rubeolës e fruthit për gratë në moshë riprodhuese;
- kontrolle falas kundër shtatëzanisë së pa dëshiruar.

Të gjithë shërbimet e lartpërmendura janë **gratis** dhe nuk është e nevojshme kërkesa paraprake tek mjeku i familjes.

7. Asistenca socialo-ekonomike

Në Alto Adige kompetenca për të ofruar shërbime sociale, në bazë të statutit mbi autonominë, i përket drej-përdrejt **Provincës Autonome të Bolzanos**.

7.1. QENDRAT E SHËRBIMIT SOCIAL: KOMUNITETET NDIHMËSE DHE QENDRAT SHËNDETËSORE TË BOLZANO-S

Provincia Autonome e di Bolzano-s ka deleguar kryerjen e shërbimeve sociale tek Bashkitë, të cilat e kanë nëndeleguar tek Komunitetet Ndihmëse (**Comunità Comprensoriali**), dhe mbi territorin e qytetit të Bolzano-s administrimi i të gjitha funksioneve socio-asistencial i janë besuar nga Bashkia tek **Azienda Servizi Sociali di Bolzano** (ASSB).²⁹

Qendra e shërbimit social në Bolzano

Që prej 1 janarit të 1999 në qytetin e Bolzanos të gjitha shërbimet sociale drejtohen nga një ent i cili quhet Azienda Servizi Sociali di Bolzano (A.S.S.B.) e cila ashtu si Comunità Comprensoriali, kujdeset nëpërmjet promovimit mirëmbajtjes dhe rekuperimit, mirqënien e shtetasve që jetojnë në Bashkinë e Bolzano-s, duke suajtur autonominë personale dhe familjare.

PËR KË ?

- të rinjtë;
- familjet;
- të moshuarit;
- personat me handicap;
- personat me sëmundje psiqike;
- persona në vështirsi sociale.

SI?

- asistencë ekonomike (për personat me pak të ardhura);
- ndihmë shtëpiake;
- asistencë sociale;
- asistencë pedagogjike dhe edukuese;
- asistencë në vëndin e punës;
- çerdhe për fëmijët;
- “Tagesmütter”;
- Konsultori familjar;

.....
29 Për më shumë informacion: <https://www.aziendasociale.bz.it/it>

- Qendra kundër dhunës shtëpiake (centro di ascolto antiviolenza);
- Shtëpia e gruas;
- Sub Way – hapsirë për të rinjtë;
- shërbimi për të moshuarit “emergenza anziani”; centri diurni per anziani;
- qendra për asistencë gjatë ditës për të moshuarit;
- mensa për të moshuarit;
- qëndrim në kushte klimatike për të moshuarit;
- shtëpitë e pushimit dhe të rehabilitimit;
- handikapat dhe vështirësitë psikike;
- persona në vështirsi (mikpritja e parë ndaj shtetasve të huaj, kampet për nomadët për sintët dhe romët, shërbime për personat e varur nga droga, vënde fjetjeje për meshkujt dhe femrat).

7.2. DISTRIKTI SOCIO-SHËNDETSOR

PËR KË?

Distrikti Socio-Shëndetësor është pika e parë e referimit ku qytetari mund të drejtohet për nevoja sociale ose shëndetsore të ndryshme.

SI?

Distrikti ofron:

- Informacion e konsulencë për shërbimet sociale e shëndetsore;
- Shërbime sociale dhe shëndetësore të cilat mund të merren në vënd ose në shtëpinë e personit ose në struktura të tjera në lagje.

Shërbimet sociale– asistenciale të ofruara nga distrikti janë si më posht:

- asistencë ekonomike;
- ndihmë në shtëpi;
- asistencë sociale;
- asistencë pedagogjike edukuese;
- asistencë pranë vendit të punës;

7.3. SHËRBIMET E DISTRIKTI

Asistenca ekonomike

PËR KË?

Shërbimi i ndihmës ekonomike parashikon dhënien e shumave të parave për familjet dhe personat vetëm/singël të cilët gjenden në vështirësi ekonomike të veçantë.

SI?

Ndihma ekonomike përfshin:

- **Të ardhura minimale për përfshirjen**, për plotësimin e nevojave themelore të jetesës si strehimi dhe ushqimi; kush përfiton nga ky shërbim gjithashtu mund të përfitojë dhe dokumentacionin e nevojshëm për përjashtimin nga pagesa e kuotës shëndetësore;
- Shërbime të veçanta për të përballuar rrethana në të cilat duhen bërë shpenzime të jashtëzakonshme në raste urgjente vetjake ose familjare.
- **Ndër të cilat:**
 - Kthimin e shpenzimeve për "telesoccorso";
 - kontribut në shpenzimet e instalimit të telefonit për të moshuarit;
 - kontribut për personat me hendikap në blerjen dhe adaptimin e mjeteve motorrike;
 - pagesa e shpenzimeve përkatëse për kujdestarinë në familje në favour të të miturve;
 - kontribut për asistencën mbi fëmijet deri në 3 vjeç pranë asistentëve në shtëpi ("Tagesmütter").

Ndihma në shtëpi**PËR KË?**

Shërbimi mund të kërkohet nga persona që janë pjesërisht ose plotësisht të paafte nga pikpamja fizike dhe/ose mendore, jo më në gjendje për të administruar vetë jetën e tyre familjare pa ndihmë të jashtme.

Ky shërbim qëndron në dhënien e shërbimeve direkt pranë shtëpisë së personit, ose në qendrat ditore për të moshuar, më qëllim për të ulur numrin e atyre që shtrohen në strukturat e asistencës apo rezidencës për të moshuar.

KU?

Në distriktin **Socio-Shëndetësor** do të merrni të gjitha informacionet në lidhje me shërbimin, si dhe mund të paraqiten kërkesat përkatëse për të përfituar nga shërbimi.

Bolzano: Don Bosco

Piazza Don Bosco 11

39100 Bolzano

Tel. 0471 541 010

Fax.: 0471 541 050

E-mail: distretto-amm.bolzano@sabes.it

Bolzano: Europa-Novacella

Via Palermo 54
39100 Bolzano
Tel. 0471 541 101
Tel. 0471 541 102
Fax: 0471 541 120
E-mail: distretto-amm.bolzano@sabes.it

Bolzano: Gries-San Quirino

Piazza Wilhelm-Alexander-Loew-Cadonna 12
39100 Bolzano
Tel. 0471 909 122
Tel. 0471 909 113
Fax: 0471 909 116
E-mail: distretto-amm.bolzano@sabes.it

Bolzano: Oltrisarco

Via Pietralba 10
39100 Bolzano
Tel. 0471 469 425
Fax: 0471 469 430
E-mail: distretto-amm.bolzano@sabes.it

Bolzano: Centro-Piani-Rencio

Via Renon 37
39100 Bolzano
Tel. 0471 319 503
Fax: 0471 319 520
E-mail: distretto-amm.bolzano@sabes.it

Asistenza sociale**PËR KË?**

Shërbimi i Asistencës Sociale, ndërhyr për ata qytetarë të cilët ndodhen në vështirësi ekonomike, duke ndërtuar sëbashku me personin një rrugëtim ndihme. Shërbimi ofrohet nga asistentët social.

SHËRBIMET QË OFROHEN JANË:

- asistencë dhe konsulencë sociale për personat dhe familjet, me ndërhyrje për të zgjidhur problematikat sociale;
- informacion edhe ndihmë për akses në strukturat që ofrojnë ndihmë për fëmijët dhe familjet;
- kujdestari për fëmijët brënda dhe jashtë familjes, institute ose bashkësive të strehimit. Shërbimi është falas.

Asistencë pedagogjike dhe edukative

PËR KË?

Të gjithë qytetarët të cilet kanë nevojë për ndihma e mbështetje lidhur me zhvillimin e personalitetit.

SI?

- mikpritje dhe dëgjim;
- mbështetje, programim dhe zbatimi i ndërhyrjeve me karakter social;
- mbështetje familjeve nëpërmjet konsulencës dhe bashkëpunimit më shërbimet e ndryshme publike dhe private;
- organizimi dhe ngritja e grupeve të vullnetarëve të ndihmës personale;
- edukim në shtëpi.

Shërbimi jepet nga edukatore. Shërbimi i dhënë është falas.

Asistencë në vëndin e punës

PËR KË?

Zyra merret me përgatitjen dhe zhvillimin e projekteve për gjetjen e punës në bashkëpunim me Shërbimin e futjes në punë të Provincës Autonome të Bolzanos, për personat me te cilet kane probleme psiqike, të sjelljes, me probleme motore, neurologjike, invalidë, me probleme varësie nga droga.

8. Shtëpia dhe strehimi

PËR KË DHE SI?

Kush kërkon një apartament ka në dispozicion katër alternativa:

1. ta blejë
2. ta marrë më qira
3. paraqitja e një kërkesë për dhënie e një banese sociale
3. shtëpia-hotel³⁰

SHËNIM: Bashkimi familjar

Për të kryer bashkim familje është e nevojshme të kihet një apartament mjaftueshëm të madh për të pritur të gjithë familjen në bazë të kriterëve të fiksuara nga Komuna.

8.1. BANESA ME QIRA

PËR KË DHE SI?

Për të kërkuar një shtëpi me qira ekzistojnë disa strategji, më praktikat janë:

- kërkimi në internet në faqet e specializuara imobiliare;
- kërkimi në gazetë në lajmet që përmbajnë lajmërimi imobiliare;
- të drejtoresh tek një agjenci imobiliare.

Në të gjitha rastet, pasi gjëndet shtëpia duhet lidhur një kontratë qiraje dhe më pas kontrata duhet depozituar në zyrën e regjistrimit në Bashki. Më lidhjen e kontratës së qirasë zakonisht jepen 3 muaj parapagesë, si kaucion për pagesën e dëmeve të mundshme të shkaktuara gjatë kohëzgjatjes së qirasë plus një muaj qira paradhënie. Pra duhet të kihet në dispozicion shuma e **të paktën 4 muajve qira** në total si paradhënie. Paradhënia rimburohet në përfundimin e qirasë nëse shtëpia dorëzohet në kushte të njëjta sikur ishte marrë në fillim të qirasë.

8.2. BANESA SOCIALE

Banesat popullore jepen nga IPES-i (Istituto Per l'Edilizia Sociale), në bazë të plotësimit të kushteve të paracaktuara dhe vetëm me kërkesë, IIPES përfshin në listën e kërkesave të kërkuesve kërkesën e bërë dhe më pas jep banesën në bazë të mundësisë. Lista përfundimtare bëhet publike sëbashku me pikët e kërkuesit. Ankimi ndaj pikëve në listë duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga komunikimi i listës përfundimtare.

Ankesat egzaminohen nga Komisioni i posaçëm brenda 60 ditëve.

.....

30 Vëndet jepen nga Bashkia dhe Provinca në bashkëpunim me shoqatat lokale private ose të vullnetarizmit.

KUSH MUND TË PARAQESË KËRKESË PËR CAKTIMIN E NJË BANESE SOCIALE?

Qytetarët e mëposhtëm mund të paraqesin kërkesë për caktimin e një banese sociale, me kusht që të jenë në kushtet e e parashikuara nga ligji:

- **Qytetarët italianë ose ata të Bashkimit Europian:**
 - Kërkuesit duhet të kenë prej të paktën 5 vitesh rezidencën ose vëndin e punës në Provincën e Bolzano-s si dhe prej të paktën 2 vitesh në Bashkinë ku këta do të paraqesin kërkesën; derisa kërkuesit të mos kenë plotësuar afatin prej 5 vitesh rezidencë dhe 2 vite punë në Bashkinë ku paraqesin kërkesën, ata mund të kërkojnë dhënien e shtëpisë sociale në vëndin e rezidencës së Bashkisë prej nga ku vijnë.
- **Qytetarët të cilët nuk i përkasin Bashkimit Europian:**
 - Kërkuesit duhet të kenë prej të paktën 5 vitesh rezidencën në Provincën e Bolzano-s si dhe të kenë të paktën 3 vite punë në territorin e Provincës së Bolzano-s si dhe të kenë rezidencën ose vëndin e punës (pa ndërprerje) të paktën për 2 vitet e fundit në Bashkinë ku paraqitet kërkesa.

Të gjithë kërkuesit gjithashtu duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për të patur qasje në ndihmën për banesën sociale, të mos kaloj limitet mbi të ardhurat të nevojshme për caktimin e një banese sociale IPES (e bazuar mbi të ardhurat e dy viteve paraardhëse të paraqitjes së aplikimit) dhe mos të ketë hequr dorë nga një banesë IPES e përshtatshme.

Linki për gjetjen e modularëve të kërkesës për banesë sociale:

http://www.ipes.bz.it/download/2018_DOMANDA_IPES_ComuneBZ.pdf

SHËNIM: Kërkesa për dhënien e një banese sociale duhet bërë dhe rinovuar çdo vit.

8.3. NDIHME EKONOMIKE PËR PAGESËN E QIRASE DHE PËR SHPENZIMET AKSESORE

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Familjeve dhe personave singël në nevojë, mund ti jepet një kontribut për shpenzimet e qirasë dhe për shpenzimet aksesore, të lidhura me apartamentin ku jetojnë. Shuma varet nga gjëndja ekonomike e familjes si dhe nga shpenzimet realisht të kryera të cilat i rezultojnë Provincës nga Kontrata e Qirasë.

PARAKUSHTET PËR AKSES

Kanë akses në dhënie e ndihmës ekonomike dhe sociale personat e mëposhtëm, me kushtin që të kenë banim të pandërprerë prej të paktën 12 muajsh në provincën e Bolzanos, përpara paraqitjes së çdo kërkesë:

- qytetarët italian;
- qytetarët të cilët i përkasin një vendi anëtar të Bashkimit Europian;
- qytetarët të cilët zotërojnë një leje qëndrimi me afat të gjatë EU, të lëshuar në Itali;
- titullarët e statusit të refugjatit;
- titullarët e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.

Gjithashtu kanë akses në dhënie e ndihmës ekonomike dhe sociale personat e mëposhtëm, pas 5 vitesh banimi dhe rezidence të pandërprerë në provincën e Bolzanos, nëse janë rezidentë të lighshëm në territorin kombëtar:

- qytetarët e shteteve të treta;
- Personat pa shtetësi.

PËR MË SHUM INFORMACION

<http://www.provincia.bz.it/famiglia-sociale-comunita/persona-in-difficolta/default.asp>

8.4. SHTËPITË HOTEL

Qytetarët e huaj të cilët qëndrojnë ligjërisht në Itali, mund të aksesojnë në një **shtëpi-hotel për punonjësit nëse punojnë**.

Shtëpitë-hotel për punonjësit janë struktura të pritjes dytësore të drejtuara nga IPES ose nga organizata private ose të vullnetarizmit të cilat disponojnë lejet përkatëse. Për të përfituar nga qëndrimi në shtëpitë-hotel duhet paraqitur një kërkesë tek IPES. Kërkesa mund të paraqitet në çdo moment.

LINK PËR MODULARËT E KËRKESËS

[http://www.ipes.bz.it/download/2.Richiesta_per_l_ammissione_alle_case_albergo_per_lavoratori_\(versione_maggio_2018\).pdf](http://www.ipes.bz.it/download/2.Richiesta_per_l_ammissione_alle_case_albergo_per_lavoratori_(versione_maggio_2018).pdf)

SHTËPITË HOTEL PËR PUNONJËSIT

Në Bolzano janë në dispozicion 7 struktura me një total prej 410 shtetërisht të disponueshëm³¹.

31 Qëndrimi në shtëpitë hotel të punonjësve nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vite. Gjithsesi IPES mund të autorizojë qëndrimin mbi 5 vite nëse ka disponibilitet shtetërisht. Për të aksesuar në shtëpitë hotel nuk kërkohet qëndrimi në Provincën e Bolzanos me mbi 5 vite.

Sistemimi mund të jetë në mini dhoma ose në shtretër (maksimumi 7 shtetër për ambient) të cilët u jepen punonjësve të cilët plotësojnë këto kritere:

- të kenë një punë të rregullt ose
- të kryejnë aktivitet profesional si të vetëpunësuar ose
- të jenë regjistruar në listat e punësimit prej jo më shumë se 8 muajsh, me kushtin që në momentin e regjistrimit në listën e të papunëve kërkuesi të ketë patur për të paktën një vit një marrëdhënie pune në Provincën e Bolzanos, ose
- të ndjekë një projekt të futjes në punë.

Mysafiri paguan një kuotë ditore e cila përfshin qiarnë e përcaktuar si dhe shpenzimet aksesore. IPES përcakton kuotën vit për vit.³²

8.5. BLERJA E SHTËPISË

BLERJA E SHTËPISË SË PARË

Provinca Autonome e Bolzano-s i jep familjeve dhe personave singël përparësi/ndihmë për blerjen e shtëpisë së parë. Bëhet fjalë për një kontribut që nuk kthehet më për Provincën i cili jepet në një shumë të vetme.

Për të përfituar nga kjo ndihmë, kërkuesi duhet të plotësojë disa kritere të cilat përfshijnë ndër të tjera të ardhurat dhe pasuritë e patundshme të kërkuësve si dhe të prindërve, të vjehrrit/vjehrrës si dhe të fëmijëve.

KRITERET PERSONALE TË KËRKUESIT:

Kërkuesi duhet të kenë prej të paktën 5 vitesh rezidencën ose vëndin e punës në Provincën e Bolzano-s. E njëjta gjë vlen dhe për bashkëjetuesin “more uxorio” (sipas nënit. 7 del D.P.G.P 1999/42), nëse ky bëhet bashkëpronar i banesës; qytetarët të cilën nuk i përkasin Bashkimit Europian, në momentin e paraqitjes së kërkesës, duhet të kenë jëtuar pa ndërprerje ligjërisht, prej të paktën 5 vitesh në territorin e provincës dhe duhet të kenë kryer një punë gjithmonë në territorin e provincës për të paktën 3 vite;

Kërkuesi duhet të ketë mbushur moshën 23 vjeç, nëse kërkuesi është i pa martuar apo i ve dhe pa familjarë në ngarkim. Ky kriter nuk aplikohet për kërkuesi me handicap me invaliditet mbi 74%;

.....

32 Në rastin kur mysafiri nuk zbaton rregullat e parashikuara në marrëveshjen për caktimin e shtratit ose të mini dhomës, efekti është revokimi i këtij/kësaj të fundit.

Në rastin e revokimit nuk mund të kryhet më kërkesë për caktim të shtratit apo mini dhomës për 5 vitet në vazhdim.

Kërkuesit të cilët janë të detyruar të deklarojnë grupin gjuhësor, duhet të bashkëlidhin këtë deklaram me kërkesën e ndihmës.

Kontributi nuk kthehet³³ dhe i jepet kërkuesit i cili hyn në një nga katër fashat e të ardhurave. Kërkuesit përveç të ardhurave minimale gjithashtu duhet të arrinë një pikëzim minimal prej 20 pikësh.

PËR INFORMACION TË MËTEJSHËM:

http://www.provincia.bz.it/it/servizi-a-z.asp?bnsv_svid=1032948

KREDITË

Për të marrë një kredi mund ti drejtoheni Bankave.

Në rastin e të ardhurave të pakta, mund të merret një kredi e butë me ndihmën e Provincës së Bolzano-s, duke paraqitur kërkesë tek Zyra e Promovimit të Banesave Sociale (Ufficio Promozione Edilizia Abitativa) Mund të bëjnë kërkesë për kredi të butë vetëm personat të cilët kanë mbushur 23 vjeç.

.....

33 Për të njohur pagesën efektive, i cili varet dhe nga sipërfaqja ose nga çmimi i blerjes së banesës, është e nevojshme ti drejtoheni një gjeometri të zyrës teknike për banesën sociale (ufficio tecnico per l'edilizia agevolata). Është e mundur të kryhet edhe simulimi online e kompletuar me llogaritjen teknike. Në seksionin e përlllogaritjes online të sipërfaqes, të vlerës dhe të pagesës në provincë, gjenden informacione të mëtejshme mbi sipërfaqen e përcaktuar si dhe atë neto.

9. Shkollimi dhe universiteti

Shkolla u jep mundësi të rinjve për të rritur intelektin dhe për tu përgatitur për një profesion.

Shkollimi i të rriturve u drejtohet personave që dëshirojnë të marrin ose të thellojnë përgatitjen profesionale jasht ciklit të studimeve shkollë. Bëhet fjalë për kurse specializimi me objektiv të qartë dhe të tipit praktik me afat të përcaktuar që shpesh herë përfshijnë edhe një periudhë stazhi në ndërmarrje.

9.1. REGJISTRIMI SHKOLLOR

Në Itali të gjithë fëmijët duhet të regjistrohen në shkollimin e detyrueshëm e cila përfshin frekuentimin e ciklit shkollor nga 6 deri në 16 vjeç si dhe formimin profesional deri në mbushjen e moshës madhore. Të gjithë fëmijët duhet të regjistrohen në shkollën e detyrueshme, edhe ata pa leje qëndrimi, për regjistrimin **mjafton certifikata e vaksinimit dhe certifikata mjeksore**. Në Provincen e Bolzano-s ekzistojnë shkolla me mësim në gjuhën gjermane, italiane dhe ladine.

SI?

Regjistrimi në shkollë mund të kryhet në çdo periudhë të vitit shkollor. Fëmijët që ndodhen në Itali kanë të drejtën e shkollimit edhe nëse nuk kanë leje qëndrimi të rregullt.

- Regjistrimi në shkollë bëhet moshës duke futur fëmijën në klasën përkatëse sipas
- moshës, përjashtimisht në rastet kur Këshilli i Mëesuesve vendos regjistrimin e fëmijës në një vit para ose pas përkatëse (në baze të aftësive dhe zhvillimit të tij).
- Për njohje sa më të shpejtë të gjuhës italiane ose gjermane mund të organizohen nga ana e shkollës kurse intensive.
- Për mënyrën e komunikimit midis shkollës me fëmijën dhe familjen e tij, mund të përdoren **Ndërmjetës Kulturor të kualifikuar** (mediatori interculturali qualificati).
- Me shoqatat e ndryshme të hauja si dhe me ato të vullnetarizmit, shkolla mund të ndërmarrë projekte të pritjes dhe të edukimit ndërkulturor.

9.2. ÇERDHJA

Bashkia e Bolzanos administron çerdhet nëpërmjet “ASSB”. Mund të regjistrohen fëmijët duke filluar nga muaji i 3° pas lindjes e deri në

mbushjen e moshës 3 vjeç. Kërkesa mund të behët menjëherë pas lindjes së fëmijës. Frekuentimi nuk është i detyrueshëm por më mungesë të tejzgjatur familja ftohet të rrimarë fëmijën për mungesë frekuentimi. Shërbimi është me pagesë. Orari zakonisht është nga ora 7.30 deri në orën 17.00.

Për informacion lutemi ti drejtoheni Zyrës së Shërbimeve për Familjen (Ufficio Servizi alla Famiglia dell'ASSB)

LISTA E ÇERDHEVE (ASILO NIDO) BASHKIAKE

- Asilo Nido Casanova
- Asilo Nido Firmian
- Asilo Nido Il Grillo
- Asilo Nido Il Panda
- Asilo Nido Il Quadrifoglio
- Asilo Nido Il Sole
- Asilo nido Il Veliero
- Asilo Nido La Farfalla
- Asilo Nido La Nuvola
- Asilo Nido L'Acquario

9.3. KOPSHTI PËR FËMIJËT

Kopshtet në Bolzano ndahen sipas zonave të përkatësisë, dhe administrohen nga Shërbimi i Kopshteve për fëmijë të bashkisë së Bolzano-s (me përjashtim të kopshteve private të cilat kanë marrëveshje me Bashkinë e Bolzano-s)

Është e mundur të regjistrohen fëmijët nga 3 deri në 5 vjeç. Egzistojnë kopshte bashkiake ose kopshte private. Për kopshtet publike, regjitrimi bëhet zakonisht në kopshtin pranë shtëpisë, në muajt e janarit dhe shkurtit.

REGJISTRIMI NË SHKOLLËN FILLORE (SCUOLA DELL'INFANZIA)

Lidhur me të gjithë informacionin për regjistrim dhe procedurën përkatëse për regjistrimin në shkollën fillore, prindërit mund ti drejtohen koordinatorës së shkollës ose:

- për shkollën fillore në gjuhën italiane, mund të drejtohen tek Qendra e Kërkimit dhe Dokumentimit të Provincës Autonome të Bolzano-s në Via Duca d'Aosta 101, Bolzano - Tel. 0471 400 719;
- për shkollën fillore në gjuhën gjermane, mund të drejtohen tek Drejtoria Didaktike e shkollave në gjuhën gjermane (Direzione didattica delle Scuole dell'Infanzia in lingua tedesca) , Via Brennero 3, Bolzano - Tel. 0471 982 200.

PËR MË SHUM INFORMACION

https://www.comune.bolzano.it/servizi_context01.jsp?ID_LINK=3742&area=51

Shkolla me detyrim: karakteristika të përbashkëta të shkollës së gradës së parë dhe të dytë, cikli i parë (fillore dhe të mesme)

Shkolla fillon në shtator dhe mbaron në qershor (një vit shkollor). Regjistrimi dhe frekuentimi i shkollës është falas dhe me detyrim. Regjistrimi mund të bëhet në ç'faredolloj periudhe të vitit shkollor. Për fëmijet që vijnë dhe kanë filluar ciklin shkollor në një vënd tjetër, vendos shkolla në cilën klasë t'i regjistrojë. Regjistrimi bëhet duke paraqitur kërkesën pranë shkollës që dëshirohet, (zakonisht asaj më pranë banesës) gjatë muajit janar për ata që bëjnë regjistrimin në klasën e pare fillore.

Kalon vitin shkollor nxënësi i cili kalon klasën me anë të vlerësimit pozitiv nga ana e mesuesve mbi mbarëvajtjen shkollore të fëmijes. Nëse vlerësimi në disa lëndë është negativ, atëherë nxënësi përsërit klasën. Një ndër lëndet që mësohet në shkollë është edukimi fetar, për të cilën mund të bëhet kërkesë që fëmija mos të marri pjesë në orët e edukimit fetar nëse familja nuk është dakord.

Në fund dhe në mes të vitit shkollor nxënësit marrin dëftesat me vlerësimin me shkrim që u bëhet nga ana e mësuesve të të gjitha lëndëve. Prindi firmos vlerësimin i cili i kthehet shkollës. Zakonisht fëmijëve u jepen detyra shtëpie për të përforcuar nocionet e mësuara në shkollë.

Librat merren hua nga shkolla dhe mbahen me kujdes përgjat gjithë vitit shkollor dhe në përfundim të tij i dorëzohen shkollës për tu përdorur nga nxënësit e tjerë. Dy herë në vit bëhen takime prindër-mësues (**udienze generali**). Çdo mësues/e vendos një ditë të javës në një orar të caktuar për tu takuar me prindërit e nxënësve (**udienza singola**) për probleme lidhur me mbarëvajtjen shkollore. Prindërit e nxënësve emerojnë mes tyre një **përfaqësues për klasën**, i cili ndihmon në marrëdhëniet midis shkollës dhe prindërve. Mungesat, ardhja me vonese ose dalja para kohe duhet gjithmonë të justifikohen nga prindi tek librezja e komunikimeve shkollë-familje ose nëpërmjet **regjistrimit digital**.

Regjistrimi Digital është një mjet i rëndësishëm komunikimi nëpërmjet Webi-t. Në të shënohen notat e nxënësve, mungesat, detyrat e caktuara për do lëndë si dhe vlersimet e ndërmjetme të çerekut të simestrit si dhe të fundvitit të shkollimit, sëbashku me dokumenta të tjerë të rëndësishëm. Në rast sëmundje, pas 5 ditësh mungesë të njëpasnjëshme femija duhet të rikthehet në shkollë përveç se me justifikimin nga prindi edhe më raportin mjekësor. Disa shkolla parashikojnë ndihmë për

fëmijët të cilët kanë vështirësi në të kuptuarit e gjuhës, me ndihmën e ndërmjetësve kulturor të cilët flasin gjuhën e tyre për një periudhë kohe të limituar.

Nëse shkolla e parashikon, fëmija mund të regjistrohet në një klasë me orar të zgjatur zakonisht deri në orën 16:00 (me kohë të plotë). Përveç mësimit sipas parashikimit të kalendarit shkollor, disa shkolla organizojnë dhe aktivitete jashtëshkollore ose vizita didaktike, të cilat zakonisht parashikojnë pagesën e një kuote/kontributi për regjistrim. Fëmijët mund të përdorin mensën në shkollë duke u regjistruar në shërbimin e ushqyerjes në shkollë.

Për më shumë informacion: https://www.comune.bolzano.it/servizi_context02.jsp?ID_LINK=1146&area=51

Ekzistojnë edhe aktivitete specifike në orare jashtëshkollore të drejtuara ndaj fëmijëve të huaj si ato të organizuara në Bolzano nga Drejtoritë e disa Shkollave me bashkëpunimin e kooperativave sociale dhe shoqatave aktive në zonë.

REGJISTRIMI

Për shkollën fillore (elementari), dytësore dhe të mesme dhe për gradën superiore, kërkesat mund të paraqiten:

- online,
- ose, si alternativë, në modalitetin në letër pranë sekretarisë së shkollës përkatëse.

Regjistrimi në çerdhe bëhet vetëm në modalitetin në letër;

Për te kryer regjistrimin më parë duhet të regjistroheni tek portali MyCivis³⁴ ulteriori info:

http://www.provincia.bz.it/formazione-lingue/scuola-italiana/downloads/Iscrizioni_OnLine_presentazione.pdf

www.my.civis.bz.

.....

34 Është e domosdoshme aktivizimi i mëparshëm i kartës së shërbimeve në çdo bashki të Alto Adige-s, e më pas të lidheni tek portali my.civis.bz. Nëse ka probleme teknike në lidhje me kartën e shërbimeve osë në shërbimin online duhet ti drejtoheni numrit të gjelbër 800 816836, ose të dërgoni një e-mail tek servicedesk@provinz.bz.it

9.4. SHKOLLA FILLORE (ELEMENTARE)

PËR KË?

Për të gjithë fëmijët që kanë mbushur moshën 6 vjeç.

Duhet të regjistrohen në klasë të parë të gjithë fëmijët të cilët mbushin 6 vjeç brenda datës 31 gusht, por mund të regjistrohen edhe fëmijët të cilët mbushun 6 vjeç brenda datës 30 prill të vitit shkollor të referimit.

SI?

Kohëzgjatja normale është 5 vite. Në fund të vitit të pestë kryhet një provim përfundimtar për dëftesën elementare (licenza elementare), me kalimin e këtij provimi mund të regjistrohesh në shkollën e mësimi të ulët.

Info: https://www.comune.bolzano.it/servizi_context02.jsp?ID_LINK=2364&area=0

9.5. SHKOLLA DYTËSORE E GRADËS SË PARË (E MESME E ULËT)

PËR KË?

Për të gjithë fëmijët të cilët kanë kaluar privimin e klasës së pestë fillore, ose zakonisht me plotësimin e moshës 11 vjeçare kanë një titull ekuivalent të marrë në shtetin e origjinës të njohur si të përshtatshëm nga shkolla. Nëse nuk ngelin ndërkohë, nxënësit përfundojnë shkollën e mesme të ulët në moshën 14 vjeçare. Nëse nuk kalohet provimin në vitin e tretë, frekuentimi është i detyrueshëm të paktën deri në plotësimin e moshës 16 vjeçare.³⁵

SI?

Kohëzgjatja normale është 3 vjet. Në vitin e tretë kryhet një provim për marrjen e dëftesës e shkollës 9 vjeçare (Licenza media finale) e cila lejon regjistrimin në shkollën e mesme të lartë (Gjimnaz).

9.6. SHKOLLA TË MESMË TË GRADËS SË DYTË (GJIMNAZI -LICEU)

Mund të regjistrohen vetëm ata të cilët kanë marrë një dëftesë të shkollës 8 - 9 vjeçare (Licenza media finale), pra duke filluar nga mod 'sha

.....

35 Për vitin shkollor 2018/19 regjistrimin në klasën e parë të shkollës dytësore të gradës së parë për të njëjtin Institut shkollor të frekuentuar, kryhet automatikisht brenda datës 31.01.2018. nëse shkolla fillore e frekuentura nuk bën pjesë në një Institut shkollor me shkollë dytësore të gradës së parë, regjistrimin bëhet gjithsesi në klasën e parë të shkollës dytësore të gradës së parë e cila është kompetentë për territor. Regjistrimi në shkollën e dytë dhe të tretë bëhet në mënyrë automatike nga vet shkolla.

14 vjeçare. Janë shkolla të mesme Licetë (klasik, shkencor, gjuhësor, artistik), shkollat teknike (për llogaritar, gjeometër, ekspert industrial), institutet profesionale (sektori i tregtisë dhe turizmit, sektori i industrisë dhe artizanatit), instituti magjstral. Shkolla e mesme zgjat 5 vite dhe përfundon me një provim përfundimtar me kalimin e të cilit lëshohet diploma e shtetit e cila lejon regjistrimin në universitet ose frekuentimin e kurseve të specializimit pas diplomës së gjimnazit.

Kërkesa për regjistrim në shkollën e mesme (Gjimnaz/Lice) mund të kryhet:

- online ³⁶
- ose, si alternativë, në modalitetin në letër pranë sekretarisë së shkollës përkatëse

Regjistrimi në vitin e parë është i detyrueshëm, ndërsa regjistrimi në vitet pasardhëse të shkollimit kryhet automatikisht nga shkolla.

9.7. UNIVERSITETI

UNIBZ është hapur në Bolzano që nga viti 1997, ka njohje ndërkombëtare.

TË STUDIOSSH TEK UNIBZ

UNIBZ ofron më shumë se 20 kursë trigjuhëshe në fushat e mëposhtme: ekonomi, shkenca natyrale, inxhinieri, informatik, shkenca të komunikimit dhe të formimit, si dhe dezajn dhe art. Disa kurse ofrohen vetëm në anglisht.

Info: <https://www.unibz.it/it/applicants/studying-at-unibz/>

Shkolla private:

Aktualisht në Bolzano ekzistojnë disa çerdhe dhe kopshte të drejtuara nga privatet, si dhe shkolla të mesme private. Ka disa shkolla private të cilat mundësojnë frekuentimin e kurseve të fitimit të viteve shkollore të humbura deri në përfitimin e diplomës së maturës.

.....
36 Është e domosdoshme më parë të aktivizohet Karta e Shërbimeve në çdo bashki të Alto Adige-s dhe më duhet të lidheni me portalin <https://my.civis.bz.it/public/it/default.htm>. Për probleme teknike në lidhje me Kartën e Shërbimeve dhe të shërbimit on-linë, duhet ti drejtoheni numrit të gjelbër 800 816836, ose të dërgoni një e-mail tek servicedesk@provinz.bz.it

9.8. FORMIMI I TË RRRITURVE

Për të rriturit të cilët nuk kanë titull studimi të shkollës së detyrueshme, ekzistojnë kurse nate për punonjësit (shkollë nate) me kohëzgjatje prej 150 orësh. Për të ndjekur orët mësimore të rriturit kanë disa avantazhe në lidhje me orarin e punës. Kohëzgjatja korrespondon me atë të vitit shkollor.

Informacion i mëtejshëm mund të kërkohet tek shkolla e mesme **Leonardo da Vinci**.

Në Bolzano, në qendrat kryesore të Provincës organizohen edhe **kurse gjuhe për të huaj**. Ër kurse në italisht në Bolzano, mundnd ti drejtoheni shkollës së mesme **Dante Alighieri** ose enteve private të formimit të specializuara në fushën gjuhësore. Në Bolzano, në via **Piave 3**, Shërbimi i Fondit Social Europian (**Fondo Sociale Europeo FSE**) informon mbi të gjitha kurset e formimit profesional që organizohen në provincë me kontributet e Bashkimit Europian.

9.9. NJOHJA E TITUJVE TË STUDIMIT TË MARRA JASHTË SHETIT

Kompetenca për **njohjen e titujve të studimit** të marra jashtë shtetit për të aksesuar në studimet universitare i njihet Universitetit si dhe Istituteve të shkollimit universitar, të cilat e ushtrojnë në autonomi të plotë si dhe në përputhje me ligjet përkatëse, duke patur parasysh edhe marrëveshjet bilaterale të fushës, si dhe ato ndërkombëtare.

9.10. NJOHJA E TITUJVE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT

Shtetasit e huaj të cilët qëndrojnë ligjërisht në Itali dhe që zotërojnë një titull për ushtrimin e profesionit të marrë në një vënd i cili nuk i përket Bashkimit Europian, të cilët dëshirojnë të regjistrohen pranë urdhërave apo dhomave përkatëse, apo në listat përkatëse pranë administratave kompetente, mund të kërkojnë **njohjen e titullit për ushtrimin e profesionit** në Itali. Kërkesa për njohje duhet depozituar në **Ministrinë kompetente** duke përcaktuar profesionin i cili kërkohet të njihet. Brënda afatit prej 30 ditësh nga marrja e kërkesës Ministria cakton nëse kërkesa është e plotë apo duhet plotësuar më dokumentacion shtesë.

9.11. PARASHIKIME TË VEÇANTA PËR PROFESIONET NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Regjistrimi i shtetasit të huaj **në një trung profesional apo në listat speciale të profesionit**, për profesionet në fushën shëndetsore të cilat nuk kanë një Urdhër apo Kolegj Profesional, kryhen nga ana Ministrisë së Shëndetësisë bazuar në parashikimet e posaçme për ushtrimin e profesionit dhe vërtetimin e njohjes së gjuhës italiane. Ministria e Shëndetësisë është kompetente edhe për **njohjen e titujve shkencorë të studimit dhe të formimit profesional të cilat mundësojnë ushtrimin e profesionit** ose të një arti shëndetësor të marra në një vënd jo anëtar të Bashkimit European. Deklarata e barazvlersimit të titujve akademikë të nisëplnën shëndetësore të marra jashtë shtetit dhe pranimi në provimet korrespektive të diplomës për marrjen e titullit ose të abilitimit, kryhet me kontrollin paraprak të respektimit të kuotave të parashikuara për secilën kategori sipas Vendimit **vjetor të Kryeministrit**.

10. Formimi profesional

Provinca Autonome e Bolzano-s ofron shkolla profesionale të mësimit në gjuhën italiane dhe gjermane.

Pranë dy Formimeve profesionale të Bolzano-s do të gjeni dy **Shërbime të Orientimit profesional**.

SI?

Tipologjitë e formimit profesional në thelb janë tre:

- formim me kohë të plotë;
- formimi nëpërmjet punës për të marrë mjeshtërinë (çirak me pagesë);
- formimi i vazhdueshëm.

KU?

Formimi organizohet nga **Formimi Profesional italian, Formimi Profesional gjerman dhe Formimi Profesional ladin**.

10.1. TIPOLOGJITË E FORMIMIT

Formimi me kohë të plotë

PËR KË?

Kurset e Formimit me kohë të plotë i drejtohen atyre të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të ulët ose të cilët kanë një kualifikim profesional ose zotërojnë një dëftesë pjekurie (diploma di stato).

SI?

Kurset projektohen dhe propozohen duke patur parasysh nevojat e tregut të punës në këto sektore kryesor: agrar, hotelerisë, tregtisë dhe shërbimeve, industrisë dhe artizanatit dhe të profesioneve sociale.

KU?

Formimi organizohet nga **Formimi Profesional italian, Formimi Profesional gjerman dhe Formimi Profesional ladin**.

Formimi si çirak me pagesë (aprendistato)

Disa kontrata pune u lejojnë bizneseve/ndërmarrjeve të punësojnë të rinj, duke marrë përsipër detyrimin që ti lejojnë këta të fundit, ndjekjen për një pjesë të kohës së punës, të aktivitetit të formimit, të zhvilluar pranë Shkollës Profesionale Provinciale.

PËR KË?

Ndjekja e Shkollës Profesionale zgjat nga 3 deri në 5 vite dhe mundëson marrjen e kompetencave të domosdoshme për ushtrimin e një profesioni. Mund të marrin pjesë në këto kurse të rinjtë të cilët kanë përfunduar shkollën duke përmbushur detyrimin shkollor dhe nuk kanë kaluar moshën prej 25 vjeç, vetëm për raste të veçanta mosha mund të ngrihet deri në 29 vjeç.

SI?

Është një kontratë speciale pune në të cilën është parashikuar edhe bashkëpunimi midis punëdhënësit dhe shkollës profesionale në formimin e çirakut (apprendista) i cili paguhet shërbimin e tij në punë.

KU?

Formimi profesional organizohet nga **Formimi Profesional italian, Formimi Profesional gjerman dhe Formimi Profesional ladin**, si dhe nga **Zyra e Formimit** (Ufficio Apprendistato).

Formimi profesional në gjuhën gjermane (Formazione Professionale in lingua tedesca)

Via Dante 3, 39100 Bolzano

Tel. 0471 41 69 16

<http://www.provincia.bz.it/formazione-professionale-tesdesca/>

Kurse të formimit profesional në gjuhën italiane (Corsi di formazione professionale in lingua italiana)

Direzione provinciale Formazione professionale in lingua italiana

Via S. Geltrude 3, 39100 Bolzano

Tel. 0471 41 44 00

Fax: 0471 41 44 99

E-mail: fp@provincia.bz.it

PEC: formazioneprofessionale.berufsbildung@pec.prov.bz.it

Web: <http://www.provinz.bz.it/formazione-professionale/>

Formimi profesional i vazhdueshëm në punë

PËR KË?

Formimi i vazhdueshëm u drejtohet rë rriturve të cilët janë të punësuar ose në kërkim të punës.

Shërbimi i formimit të vazhdueshëm ka detyrën e promovimit të ofrimit të formimit të vazhdueshëm si për punonjësit të cilët dëshirojnë të ndërmarrin një rrugëtim të formimit personal ose të azhurnimit profesional, si dhe për ndërmarrjet që ndodhen në territorin e provincës, të cilat kërkojnë zhvillim të formimit për të ruajtur barazinë në treg.

SI?

Formimi i vazhdueshëm parashikon aktivitetet e mëposhtme:

- drejtimin e punonjësit i cili dëshiron të përshtasë apo të rrisë nivelin e tij profesional;
- formim i promovuar nga ndërmarrjet, në lidhje të ngushtë me risitë teknologjike dhe të organizimit.

KU?

Formimi organizohet nga **Shërbimi i Formimit të vazhdueshëm në punë (Servizio Formazione continua sul lavoro)** nga **Formimi Profesional italian, Formimi Profesional gjerman dhe Formimi Profesional latin.**

Kurse të formimit të vazhdueshëm nga Formimi Profesional në gjuhën gjermane

Centro di coordinamento Formazione continua

Via Dante 3, 39100 Bolzano

Tel. 0471 41 69 16

Fax: 0471 41 69 39

E-mail: weiterbildung.berufsbildung@provincia.bz.it

PEC: weiterbildung.berufsbildung@pec.prov.bz.it

Web: <http://www.provincia.bz.it/formazione-professionale-tedesca/>

Kurse të formimit të vazhdueshëm nga Formimi Professional në gjuhën italiane

Direzione provinciale Formazione professionale in lingua italiana

via S. Geltrude 3, 39100 Bolzano

Tel. 0471 41 44 00

Fax: 0471 41 44 99

E-mail: fp@provincia.bz.it

PEC: formazioneprofessionale.berufsbildung@pec.prov.bz.it

Web: <http://www.provinz.bz.it/formazione-professionale/>

11. Mbrojtja e të drejtave

11.1. E DREJTA PËR TU MBROJTUR

11.2. MBROJTJA FALAS

PËR KË?

Shtetasve të huaj i garantohen të njëjtat të drejta për tu mbrojtur si atyre italian.

SI?

Shtetasit e huaj nën hetim apo nën akuze, të cilët nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të paguar një avokat as në Itali dhe as jashtë shtetit, kanë të drejtë për **mbrojtje falas**, kjo do të thotë se ata mund të zgjedhin mbrojtësin e tyre i cili do të paguhet nga Shteti.

- Mbrojtja fals mund të kërkohej:
- në procedimin penal;
- në fazën e ekzekutimit të dënimit;
- në procedimin penal ndaj të miturit;
- në përcaktimin e dënimeve alternative nga ana e Gjykatës (Tribunale di Sorveglianza).

KU?

Kërkesa për ndihmë falas duhet bërë me shkresë dhe duhet depozituar ose dërguar me postë në kancelarinë e gjyqtarit i cili ndjek procedimin në gjykatë.

11.3. MBROJTËSI CIVIL - OMBUDSMANI

PËR KË?

Mbrojtësi civil është në dispozicion të të gjithë qytetarëve për ti mbrojtur ata falas në marrëdhëniet e tyre me administratën publike.

SI?

Mbrojtësi Civil ka detyrën të garantojë, duke sinjalizuar edhe më iniciativën e tij, abuzimet, mos funksionimin, mungesën apo vonesat e administratës publike në lidhje me qytetarin.

11.4. PARASHIKIME NË FAVOR TË TË MITURVE

- Fëmija i mitur i të huajit, i cili jeton me të rriturin dhe është rezident i ligjshëm, regjistrohet në lejen e qëndrimit të njërit ose të të dy

prindërve **derisa të mbushi moshën 14 vjeç**, si dhe ndejk gjëndjen juridike të prindit me të cilin jeton, ose atë më të favorshmen midis prindërve me të cilët jeton.

- Gjithashtu i mituri që rezulton **i lënë për rritje dhe edukim**, derisa të mbushi moshën 14 vjeçare (sipas nenit 4 të ligjit datë 4.05.1983, n. 184), regjistrohet në lejen e qëndrimit të të rriturit të cilit I është lënë për rritje dhe edukim dhe ndjek gjëndjen juridike të këtij të fundit nëse kjo gjëndje është më e favorshme.
- Mungesa e përkohshme nga territori i Shtetit Italian nuk përjashton kushtin e bashkjetesës së fëmijes me prindin si dhe rinovimin e regjistrimit.
- **Me mbushjen e moshës 14 vjeç**, të miturit i lëshohet një leje qëndrimi për arsye familjare i cili vlen deri në mbushjen e moshës madhore.
- Gjykata për të miturit, për arsye të rënda të lidhura me zhvillimin mendor, mund të autorizojë hyrjen ose qëndrimin e një familjari, për një kohë të caktuar edhe në tejkalim të parashikimeve të ligjit për imigracionin.
- Kur merret vendim për dëbimin e një të mituri të huaj, vendimi ekzekutohet me kërkesë të Kuestorit nga ana e Gjykatës pëe të miturit.

11.5. MASA KUNDËR DISKRIMINIMIT RACOR

Teksti unik për migrimin parashikon disa rregullime kundër akteve të diskriminimit racor dhe të intolerancës ndaj të huajve.

Gjithashtu ligji i datës 25 qershorit të vitit 1993, nr. 205, është një akt legjislativ i Republikës së Italisë i cili sanksionon dhe dënon gjestet, veprimet dhe parrullat e lidhura me ideologjinë nazi-fashiste, të cilat kanë si qëllim nxitjen e dhunës dhe diskriminimit për arsye race, etnie, feje apo kombësie. Ligji dënon edhe përdorimin e simboleve të lidhura me lëvizjet politike të këtij lloji ³⁷

.....
37 Neni 1 ("Diskriminimi, urrejtja dhe dhuna për arsye race, etnike, kombësie dhe feje") parashikon si vijon: "përveç kur fakti përbën vepër penale më të rëndë, [...] ndëshkohet:

a) me burgimin deri në një vit e gjashtë muaj ose me gjobë deri në 6.000 euro kush propagandon ide të bazuara mbi superioritetin ose mbi urrejtjen racore apo etnike ose shtyn në kryerjen apo kryen akte diskriminimi për arsye race, etnie, feje, kombësie;

b) me burgosjen nga 6 muaj deri në 4 vite për atë i cili në çfardollos mënyre shtyn në kryerjen apo kryen dhunë ose akte të cilat provokojnë dhunën për arsye racore, etnike, kombëtare apo fetare.

Është e ndaluar çdo shoqate apo organizim tjetër, lëvizje apo grup i cili ka në qëllim të tij, nxitjen e diskriminimit ose të dhunës për arsye racore, etnike, kombëtare apo fetare. Kush merr pjesë në këto organizata, shoqata, grupe apo lëvizje ose jep ndihmë për kryerjen nga këto të fundit të aktivitetit të mësipërm, ndëshkohet vetëm për faktin e pjesëmarrjes ose të dhënies së ndihmës me dënimin me burgim nga 6 muaj deri në 4 vite. Ato të cilët promovojnë dhe drejtojnë këto organizata, shoqata, lëvizje apo grupe ndëshkohen me dënimin nga 1 deri në 6 vite burgim"

PËR KË?

Janë masa të ndërmarra për të ndëshkuar ata të cilët kryejnë akte diskriminimi për arsye të “racës apo ngjyrës”, të përkatësisë “kombëtare, fetare apo etnike si dhe kush vë në rrezik njohjen dhe ushtrimin e të drejtave të njëriut në çdo sektro te jetës publike.

KUNDËR KUJT?

- Këto masa janë drejtuar kundër:
- oficerit publik ose personave të cilët ushtrojnë shërbim publik/funksione publike, të cilët në ushtrimin e detyrës kryejn ose nuk kryejn akte ndaj një shtetasi të huaj i cili diskriminohet pa të drejtë vetëm për faktin se është i huaj;
- gjithkujt, i cili vendos kushte më pak të favorshme ose refuzon ti japë një të huaji të mira dhe shërbime të ofruara ndaj publikut të gjërë;
- gjithkujt, i cili vendos kushte më pak të favorshme ose refuzon të ofrojë akses në punësim, në strehim, në shkollim, në formim, si dhe në shërbimet sociale të huajit i cili qëndron ligjërisht në Itali, vetëm për shkak se ky i fundit është i huaj;
- gjithkujt i cili ndalon ushtrimin e një aktiviteti ekonomik të ndërmarre në mënyrë të ligjshme nga një i huaj;
- gjithkujt, i cili kryen akte diskriminimi ndaj një të huaji në vëndin e punës;
- gjithkujt, i cili kryen veprime xenofobe apo raciste.

SI DHE KU?

Denoncimi paraqitet me shkrim në kancelarinë e Gjykatës së Zakonshme të vëndit ku ka qëndrimin ai i cili e paraqet.

12. Kultura, edukimi kultura e përbashkët

12.1. QËNDRA PËR ZHVILLIMIN E KULTURËS

12.2. EDUKIMI NDËRKULTUROR

PËR KË?

Shtetasit e huaj të cilët ndodhen në territorin e Provincës autonome të Bolzano-s mund të përfitojnë nga shërbimet e ofruara nga qendrat për zhvillimin e kulturës dhe mësimin e gjuhës.

SI?

Institucionet kompetente ndërhyjnë në fushën e të rinjve, në fushën jashtëshkollore, në sektorin e edukimit të qëndrueshëm dhe në fushën shkencore.

KU?

Promovimi i mësimin të gjuhëve të huaja është detyrë e Zyrës së Dygjuhësisë dhe gjuhëve të huaja (Ufficio Bilinguismo e lingue straniere), për sektorin e Kulturës Italiane, dhe nga Zyra e Edukimit të Vazhdueshëm (Ufficio Educazione Permanente) për sektorin e Kulturës gjermane.

<http://www.provincia.bz.it/arte-cultura/>

12.3. BASHKËPUNIMI DREJT ZHVILLIMIT

PËR KË?

Si Provincia Autonome e Bolzano-s ashtu edhe Bashkia vendosin në dispozicion si të personit ashtu edhe të Asocacioneve me seli në Provincën e Bolzanos, kapital financiar dhe njërëzor në favor të promovimit të aktivitetit të bashkëpunimit dhe të kulturës së paqes dhe solidaritetit për vëndet në zhvillim.

SI?

Të interesuarit mund të paraqesin kërkesën për kontribute në bazë të kriterëve të caktuara në garat publike të publikuara nga Shërbimi për kooperimin në zhvillimin e Provincës Autonome të Bolzano-s (*Servizio per la cooperazione allo sviluppo della Provincia Autonoma di Bolzano*) ose tek Zyra e Familjes, Gruas dhe Rinisë dhe promovimin socia të Bashkisë së Bolzano-s (*Ufficio Famiglia, Donna e Gioventù e Promozione sociale del Comune di Bolzano*).

Info:

<http://www.provincia.bz.it/politica-diritto-relazioni-estere/cooperazione-sviluppo/default.asp>.

http://www.comune.bolzano.it/servizi_context02.jsp?ID_LINK=3071&area=39

KU?

Zyra kompetente për promovimin e këtyre kontributeve për Provincën e Bolzano-s është: (**Ripartizione Presidenza, Ufficio Relazioni estere e volontariato**), ndërsa për Bashkinë e Bolzano-s është: (**Ufficio Famiglia, Donna e Gioventù e Promozione sociale**)

Sistemi i edukimit të përhershëm

Në Bolzano egzistojnë aktualisht disa agjenci të edukimit të përhershëm të cilat ofrojnë një gamë të gjërë kursesh, seminaresh, asamble ose cilke konferencash me tematika të ndryshme.

Për më shumë informacion: <http://www.provincia.bz.it/formazione-lingue/educazione-permanente/default.asp>

Zyra gjithashtu mbulon edhe sektorët e mëposhtëm:

BIBLIOTEKAT

Sektori i bibliotekave paraqet një pikë thelbësore referimi për aktivitetet kulturore.

SHTYPI

Aktiviteti i shtypit lidhet me me aktivitetet kulturore.

QËNDRA AUDIOVISIVE E BOLZANO-S

Qendra Audio-vizive operon me shërbimet e ofruara në mbështetje të aktiviteteve kulturore ku përfshihen mediateka – me dhënien hua të filamve të autorëve, librave mbi kinemanë, revistave të specializuara, dokumentarëve mbi historinë dhe kulturën lokale, mbi artin dhe medi-at e reja - dhe sallën e monimit – me asistencën teknike në montimet audio dhe video, të prodhimeve me karakter edukues dhe kulturor dhe me konsultimin e arkivit digjital të filmave të Institutit Luce në lidhje me Alto – Adige-n.

Për më shumë informacion kontaktoni më **Zyrën 15.2. Provincia autonome e Bolzano-s.**

